



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 104

Datë 8 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|--|--|------|
| Vendim i GJK nr. 36, datë 30.6.2014 | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... | 3977 |
| Vendim i GJK nr. 37, datë 30.6.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 431, datë 3.10.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011 të Gjykatës së Lartë..... | 3981 |
| Vendim i GJK nr. 38, datë 30.6.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimeve nr. 1167/976, datë 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. 336, datë 25.2.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-953, datë 25.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) | 3990 |
| Vendim i GJK nr. 39, datë 30.6.2014 | Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 109/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”..... | 3996 |
| Vendim i GJK nr. 40, datë 7.7.2014 | Me objekt: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, të shprehjeve “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, të nenit 3, dhe “të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm” të shkronjës b/ii, të pikës 2, të nenit 3, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”; Pezullimi i zbatimit të këtyre dispozitave, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese..... | 4003 |

VENDIM
Nr. 36, datë 30.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i “ “ |
| Vitore Tusha | anëtare e “ “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i “ “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.4.2014, mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Age Musteqja

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 31, 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila u shpreh për pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a., që kërkoji rrezimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja është pronare e një toke me sipërfaqe prej 6470 m², e ndodhur në vendin e quajtur Zall-Krujë. Kërkuësja e ka fituar pronësinë mbi këtë tokë në vitin 1994 në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

2. Në vitin 2006 fabrika e çimentos "Fushë Kruja Cement Factory" sh.a., ka nisur gërmimet për argjilë në zonën Zall-Krujë. Fabrika ka kryer gërmime dhe në sipërfaqen që i përket kërkueses. Kundër këtyre veprimeve të fabrikës, kërkuësja, në fillim të vitit 2007, ka paraqitur ankim pranë Komunës Thumanë. Meqenëse dëmtimi i pronës nuk po ndalohej, kërkuësja ka paraqitur kërkesë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Krujë me objekt pushimin e cenimit të pronësisë, mospërsëritjen në të ardhmen dhe shpërblimin e dëmit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 69, datë 9.2.2010, ka vendosur: "*Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur të pushojë cenimin e pronësisë në sipërfaqen 6470 m² dhe shpërblimin e paditëses për dëmin e shkaktuar vetëm për 3 vitet e fundit.*"

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 591, datë 11.3.2011, ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 9.2.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë duke pranuar kërkesë padinë."

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-850 (182) ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 69, datë 9.2.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të vendimit nr. 591, datë 11.3.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrezimin e padisë.*"

II

6. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si antikushtetues me argumentet se:

6.1 Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Kolegji ka tejkaluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke rivlerësuar provat e marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe duke ndryshuar faktet dhe rrethanat.

6.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi përfundimi në të cilin ka arritur ky Kolegj se fitimi i titullit të pronësisë lidhet me momentin e marrjes së certifikatës së pronësisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme vjen në kundërshtim me vendimin unifikues të vetë Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 6.1.2009.

6.3 Është cenuar parimi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Civil nuk është arsyetuar në pajtim me kërkesat e dispozitave kushtetuese dhe ligjore lidhur me detyrimin për të arsyetuar një vendim gjyqësor në mënyrë të plotë dhe logjike, në zbatim edhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese për këtë qëllim. Arsyetimi i vendimit është kontradiktor dhe jologjik.

7. **Subjekti i interesuar, Shoqëria "Fushë Kruja Cement Factory"** sh.a., ka paraqitur prapësime me shkrim duke parashtruar:

7.1 Pretendimi i kërkueses nuk qëndron, pasi Kolegji Civil ka konstatuar zbatim të gabuar të ligjit dhe për këtë arsye ka vendosur prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta. Në këtë mënyrë, ajo ka respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

7.2 Nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi kërkuësja nuk ka qenë në posedim të pronës së saj në periudhën e viteve 2004-2008, për të cilën kërkuësja pretendon dëmshpërblimin si pasojë e cenimit të pronësisë. Kolegji Civil nuk i ka mohuar të drejtën e

pronësisë kërkueses, ai vetëm ka evidentuar se ajo nuk legjitimohet të ngrinte padi për periudhën gjatë të cilës ajo nuk ishte poseduese e sendit në pronësi.

7.3 Arsyetimi i vendimit të Kolegjit Civil është i plotë dhe logjik dhe ka arritur në mënyrë të natyrshme në përfundimin se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin.

III Vlerësimi i Gjykatës

A. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

8. Kërkuesja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë një vendim tej kompetencave të tij duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil, duke bërë rivlerësim të provave të marra dhe administruara nga gjykatat më të ulëta, ka vepruar si gjykatë fakti dhe jo si gjykatë ligji, gjë e cila nuk është në përputhje me parimin e gjykatës së caktuar me ligj.

9. Gjykata, në jurisprudencë të vazhduar, ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një element i procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Termi “gjykatë”, në kuptimin material, karakterizohet nga funksioni i posaçëm që ka gjykata për të zgjidhur çështjet që janë në kompetencë të saj, gjatë një procesi të zhvilluar sipas një procedure të përcaktuar me ligj dhe në pajtim me parimin e shtetit të së drejtës. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t’i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuara nga gjykatat e faktit si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin

në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuara në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe fakteve nga Gjykata e Lartë dhe nxjerrja e konkluzioneve të kundërta nga ato të gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me rolin e saj si gjykatë ligji, ka marrë prerogativat e një gjykate fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin procedural civil. Ky Kolegji ka pranuar disa herë në përmbajtjen e vendimit të tij se hetimi nga dy gjykatat më të ulëta ka qenë i paplotë dhe i pamjaftueshëm. Kështu, ai është shprehur se “Kolegji... i gjen të pabazuar në prova pretendimet”, kur faktet e rrethanat e çështjes janë të provuara me prova të administruara dhe vlerësuara nga gjykatat më të ulëta. Më tej, Kolegji Civil është shprehur në vendimin e tij se “...të dyja gjykatat e faktit kanë pranuar të provuar që paditësja është bërë pronare e parcelës me Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi në bazë të ligjit Për Tokën”, ndërkohë që Gjykata e Lartë pranon që ajo nuk ka qenë pronare në vitin 2004.

12. Gjithashtu, megjithëse në vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta është pranuar e provuar se paditësja e ka fituar pronësinë mbi sendin shumë kohë para dhënies së lejes koncesionare për palën e paditur, kjo gjë nuk pranohet nga Kolegji Civil, i cili shprehet se paditësja është bërë pronare më vonë se kur pala e paditur u pajis me leje shfrytëzimi (faqja 3 e vendimit). Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund të zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuara ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të elaboruar më lart nga Gjykata.

13. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij të njohura nga ligji procedural civil duke marrë një vendim në papajtueshmëri me elementët e procesit të rregullt ligjor, konkretisht të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit

14. Kërkuësja pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk është i arsyetuar në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Kolegji edhe pse ka marrë rolin e një gjykate fakti në kundërshtim me ligjin procedural civil, nuk e ka kryer si duhet këtë rol, duke paraqitur një arsyetim të paqartë, jologjik dhe kontradiktor.

15. Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është i bazuar dhe duhet pranuar. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Një vendim gjyqësor që të jetë mjaftueshmërisht i arsyetuar duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përfshijë çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 36, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të

tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, pasi në pjesë të caktuara të tij ka thënë që kundërshtojnë njëra tjetrën. Kështu, ndërsa Kolegji konstaton se në "...dosjen gjyqësore nuk rezulton asnjë akt i marrjes së tokës në pronësi apo akte të tjera të nxjerra në bazë të ligjit të cilat legjitimonin paditësen në paraqitjen e kërtimeve të veta", ai, më poshtë, shprehet se "...Ka rezultuar e provuar nga të gjitha provat e ndodhura në dosjen gjyqësore që i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor që në momentin që paditësja ka marrë dhe paraqitur certifikatën e pronësisë...". Më tej në arsyetimin e vendimit vërehet: "...rezulton në çështjen objekt gjykimi që paditësi e ka fituar titullin e pronësisë (nisur nga certifikata e saj e pronësisë paraqitur para gjykatës) më vonë se kur pala e paditur u pajis nga organet kompetente me leje shfrytëzimi."

19. Pra, në një pjesë të vendimit Kolegji shprehet se nuk provohet pronësia e paditësit dhe në një pjesë tjetër të të njëjtit vendim, Kolegji i referohet certifikatës së pronësisë së paditësit si dokument i administruar si provë nga gjykatat më të ulëta. Më tej, megjithëse Kolegji vë në dyshim legjitimitetin e paditëses (kërkuëses), ai sërish deklaroi se i padituri ka shfrytëzuar sendin mbi bazën e një titulli të ligjshëm dhe veprimet e tij, "qoftë edhe në pronën e paditëses", në asnjë rast nuk mund të konsiderohen si në kundërshtim me ligjin (fq.4 e vendimit). Pra, nëse Kolegji arrin në përfundimin se paditësja nuk legjitimohet në kërkimet e veta, pasi i mungon titulli i pronësisë, atëherë ai nuk mund të pranojë si të provuar se paditësja është pronare e sendit të shfrytëzuar në mënyrë të ligjshme apo jo nga i padituri. Vendimi i Kolegjit duhet të jetë i argumentuar dhe bindës për të mos lënë dyshime për asnjë nga palët lidhur me motivet ose shkaqet e prishjes së vendimeve të dy gjykatave më të ulëta, aq më tepër kur hetimi gjyqësor prej këtyre të fundit konsiderohet si i paplotë nga Gjykata e Lartë.

20. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuëses janë të bazuara dhe duhen pranuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuëses, duke mosrespektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur pranimin e kërkesës së Age Musteqja dhe për pasojë ka shfuqizuar vendimin nr. 00-2013-850 (182), datë 7.3.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Shumica ka arsyetuar se ky vendim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuarës, duke mos respektuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih paragrafin nr. 20 të vendimit*). Në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, por mendoj se ajo duhet t'i jepte përgjigje edhe pretendimit të kërkuarës lidhur me cenimin e parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye e çmoj me vend të shprehem me mendim paralel.

2. Siguria juridike qëndron në një lidhje unike me parimin e shtetit të së drejtës dhe të dyja bashkë me atë të demokracisë. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në një shtet dhe shoqëri demokratike. Jurisprudenca e kësaj Gjykate referon te ky parim konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar dhe të pritshmërive të ligjshme. Siguria juridike është një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës dhe përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore (*shih vendimet nr. 33, datë 24.6.2010, nr. 46, datë 11.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Sipas legjisllacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda

afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit të cilat janë të formës së prerë. Ndaj tyre organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore kanë detyrimin për t'i venë menjëherë në zbatim.

4. Gjithashtu Gjykata ka vlerësuar se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe fakteve nga Gjykata e Lartë dhe nxjerrja e konkluzioneve të kundërta nga ato të gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në rastin në shqyrtim, nga rrethanat e çështjes, sikurse thekson edhe shumica, rezulton se Gjykata e Lartë, në kundërshtim me rolin e saj si gjykatë ligji, ka marrë prerogativat e një gjykate fakti, duke tejkaluar kompetencat e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin procedural civil. Edhe lidhur me fitimin i titullit të pronësisë mbi sendin nga ana e kërkuarës, Gjykata e Lartë ka arritur në një përfundimin të ndryshëm nga vendimet e gjykatave të faktit duke e mbështetur vendimin e saj në fakte e rrethana, të cilat nuk janë pranuar si të vërteta nga ato gjykata si dhe duke anashkaluar konkluzionet e këtyre gjykatave mbi provat e administruara në gjykim. Gjykata e Lartë shprehet se paditësja është bërë pronare më vonë se kur pala e paditur u pajis me leje shfrytëzimi, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta (*shih paragrafët nr. 11-12 të vendimit*).

6. Në këto kushte, jam i mendimit se një vendim i tillë i Gjykatës së Lartë bie ndesh edhe me pritshmëritë e ligjshme të kërkuarës dhe cenon besimin e saj tek drejtësia për më tepër kur vendimi ka marrë formë të prerë (përfundimtare) në gjykatën e apelit. Pikërisht në këndvështrimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike, duhet trajtuar edhe arsyetimi i shumicës, sipas të cilës, nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga ai i gjykatave më të ulëta, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Ai në asnjë rast nuk mund të zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore (*shih paragrafin nr. 13 të vendimit*).

7. Nga sa më sipër, çmoj se vendimi i Gjykatës së Lartë, krahas parimeve të evidentuara nga shumica, i ka cenuar kërkuarës edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të sigurisë juridike.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM
Nr. 37, datë 30.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | | |
|-----------------|---------|---|----------|-------------|
| Bashkim Dedja | kryetar | i | Gjykatës | Kushtetuese |
| Sokol Berberi | anëtar | i | “ | “ |
| Vitore Tusha | anëtare | e | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare | e | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar | i | “ | “ |
| Besnik Imeraj | anëtar | i | “ | “ |
| Vladimir Kristo | anëtar | i | “ | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 8.4.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Dizotti” sh.p.k. (ish-shoqëria “Zoo-Al-Bushati” sh.p.k.), Edoard Rrotani, të përfaqësuar me autorizim nga avokat Thimjo Kondi

SUBJEKTE TË INTERESUAR: Pjetër Molla, Ndoc Molla, Simon Molla, Ejll Doda, Hile Doda, Preke Rrethi, Komuna Bushat, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 431, datë 3.10.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1 i Protokollit Shtesë të KEDNJ-së; neni 22 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Preambula e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, shoqërore dhe kulturore; nenet 27, 45 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Ndoc Molla dhe Sinan Molla, që kërkuan rrëzimin e kërkesës si dhe të subjekteve të tjera të interesuara, Komuna Bushat dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shoqëria Dizotti sh.p.k., ish Zoo-Al-Bushati sh.p.k., është regjistruar si person juridik me vendim nr. 31443, datë 19.4.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo ka si veprimtari tregtimin me shumicë dhe pakicë, import-eksport të produkteve dhe

nënprodukteve bujqësore, blegtorale, përpunimin e tyre etj. Në momentin e themelimit të shoqërisë, Edoard Rrotani ka qenë përfaqësues ligjor dhe ortak i saj.

2. Përpara themelimit të shoqërisë, me aktin administrativ, leje ndërtimi, nr. 5, datë 13.2.2004, Këshilli i Rregullimit të Territorit (KRT) pranë Komunës Bushat, Shkodër, i ka dhënë Edoard Rrotanit të drejtën për të ndërtuar një stallë derrash në pasurinë e paluajtshme në pronësi të tij, të regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), me një sipërfaqe prej 1.500m².

3. Kërkuari, Edoard Rrotani, pasi ka marrë lejen si më sipër, ka përfunduar ndërtimin e objektit stallë derrash, duke plotësuar dokumentacionin përkatës. Në datën 18.9.2004 është përpiluar akti i kolaudimit si dhe është nxjerrë leja e shfrytëzimit e objektit.

4. Në datën 13.5.2004, shoqëria Zoo-Al-Bushati sh.p.k., sot Dizotti sh.p.k., në përputhje me ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i është drejtuar me kërkesë Ministrisë së Mjedisit Tiranë dhe Agjencisë së Mjedisit Shkodër, për t’u pajisur me leje mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë së “mbarështimit të derrave”. Agjencia e Mjedisit Shkodër me vendimin nr. 35, datë 14.5.2004 i ka shprehur mendimin e saj organit epror, Ministrisë së Mjedisit. Kjo e fundit me vendim nr. 331, datë 9.9.2004 ka pajisur me lejen mjedisore kërkuarën. Më pas, shoqëria Zoo-Al-Bushati sh.p.k. ka filluar veprimtarinë duke shfrytëzuar stallën e derrave sipas destinacionit të përdorimit për të cilin është ndërtuar.

5. Subjektet e interesuara, Ndoc Molla etj., kanë pretenduar se aktiviteti i kryer në stallën e derrave të lartpërmendur, për shkak të erës së rëndë që vjen nga stalla, iu cenon pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme, shtëpi banimi. Sipas tyre, leja e ndërtimit nr. 5, datë 13.2.2004 nuk respekton zonën mbrojtëse sanitare prej 700 m (lineare) nga vendbanimet e tyre, sipas kritereve të VKM nr. 722, datë 19.11.1998.

6. Në këto kushte subjektet e interesuara i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesë padie me objekt anulimin e lejes së ndërtimit nr. 5, datë 13.2.2004 të lëshuar nga KRT, pranë Komunës Bushat, në favor të Edoard Rrotanit; pushimin e cenimit të pronësisë; si dhe anulimin e vendimit nr. 35, datë 14.5.2004 të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Shkodër.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 1658, datë 26.9.2005 ka vendosur pranimin e pjesës së kërkesës padisë për sa i përket kërtimeve të paditësve Ndoc Molla dhe Simon Molla. Anulimin e lejes së ndërtimit nr. 5, datë 13.2.2004 të lëshuar nga KRT, pranë komunës Bushat, në favor të Edoard Rrotanit dhe detyrimin e këtij të fundit të mos kryejë veprimtarinë në fjalë. Rrëzimin e kërtimeve të tjera të paditësve Ndoc Molla dhe Simon Molla si dhe rrëzimin

e padisë në lidhje me kërkimet e paditësve të tjerë.

8. Kundër vendimit të mësipërm kanë paraqitur ankim subjektet e interesuara Ndoc Molla dhe Simon Molla si dhe kërkuesi Edoard Rrotani. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 19, datë 23.1.2006 ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1658, datë 26.9.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe çështja është kthyer për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues. Gjykata e Apelit Shkodër ka çmuar se nuk është formuar drejt ndërgjyqësia dhe se gjykata e rrethit duhet të thërrasë si person të tretë shoqërinë Zoo-Al-Bushati sh.p.k., sot Dizotti sh.p.k.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përfundim të rigjykimit të çështjes, pasi ka zbatuar edhe detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 1300, datë 7.6.2006 ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se në rastin konkret nuk kemi cenim pronësie sepse nuk ka ndotje të ambientit (kjo e fundit është parandaluar nga teknologjia e përdorur).

10. Mbi ankimin e subjekteve të interesuar, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 431, datë 3.10.2008 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1300, datë 7.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Shkodër si më poshtë: Pranimin e kërkesë padisë. Anulimin e lejes së ndërtimit nr. 5, datë 13.2.2004 të lëshuar nga KRT, pranë Komunës Bushat, në favor të Edoard Rrotanit dhe detyrimin e shoqërisë Zoo-Al-Bushati sh.p.k. të ndalojë ushtrimin e aktivitetit të mbarështimit të derrave. Pushimin e gjykimit lidhur me anulimin e vendimit nr. 35, datë 14.5.2004 të Agjencisë së Mjedisit pranë Prefekturës Shkodër.

11. Pas rekursit të ushtruar nga palët ndërgjyqëse, Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 51, datë 27.10.2008 ka vendosur pezullimin e vendimit të mësipërm deri në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë.

12. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011 ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuetit dhe palëve të tjera ndërgjyqëse me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

13. Kërkuetit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Ata pretendojnë se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për këto arsye:

13.1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit dhe të drejtën e lirisë ekonomike të kërkuetit pasi ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse në prani:

a) të dy vendimeve diametralisht të kundërta të ofruara nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

b) të shkaqeve të ngritura në rekurs, që hyjnë në ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

13.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa i dhënë mundësi kërkuetit, nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, të paraqesin kundërshtimet e plota për rekursin e paraqitur.

13.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të vendoste kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore për shkak të shkeljes së rëndë procedurale të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë të lejuar nga gjykatat e faktit.

13.4 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë pasi nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuetit lidhur me vlefshmërinë e lejes së ndërtimit, e cila i ka prodhuar efektet e saj.

13.5 Gjykata e Apelit Shkodër nuk mund të vendoste detyrime ndaj personit të tretë si dhe të ndalonte ushtrimin e lirisë ekonomike të tij, pasi personi i tretë është thirrur nga gjykata dhe jo nga pala paditëse.

13.6 Gjykata e Apelit Shkodër e ka bazuar vendimin nr. 431, datë 3.10.2008 në mendimin e ekspertëve, të cilët nuk kanë kryer matje dhe nuk janë mbështetur në asnjë dokument shkencor. Në këtë mënyrë akti i ekspertimit është marrë në kundërshtim me nenet 11, 12, 14 dhe 214 të KPC-së.

13.7 Gjykata e Apelit Shkodër ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, lidhur me objektin e padisë për anulimin e lejes mjedisore.

14. **Subjektet e interesuara, Ndoc Molla dhe Sinan Molla**, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se:

14.1 Arsyetimi i vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk paraqet mangësi pasi forma e arsytimit të vendimeve të mospranimin të rekursit është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë.

14.2 Kërkuetit kanë pasur gjithë mundësinë praktike për t'u njohur me arsyetimin e vendimit të apelit dhe për të paraqitur plotësimin e rekursit, për pasojë mungesa e depozitimit të rekursit të plotë ka ardhur si rezultat i mosinteresimit të tyre.

14.3 Detyrimi i vendosur nga Gjykata e Apelit ndaj personit të tretë të thirrur në gjykim është konform nenit 196 të KPC-së.

14.4 Vendimi i Gjykatës së Apelit është bazuar në një analizë të hollësishme të pretendimeve të palëve, të akteve të ekspertimit topografik dhe mjedisor si dhe në këqyrjen në vend të ambientit ku zhvillohet aktiviteti i kërkuetit.

14.5 Vendimi i Gjykatës së Apelit ka analizuar dhe arsyetuar edhe në lidhje me lejen mjedisore të dhënë kërkuetit.

15. Subjektet e interesuara Ndoc Molla dhe Sinan Molla, gjithashtu, parashtrajnë se kanë paraqitur kallëzim për falsifikim dhe përdorim të falsifikuar të vendimit nr. 5, datë 13.2.2004 të KRT të Komunës

Bushat. Për këtë arsye, në datë 20.3.2014, bazuar në nenin 297/a të KPC-së, kanë paraqitur edhe një kërkesë për pezullimin e këtij gjykimi deri në shprehjen e vendimit përfundimtar të organeve të hetimit.

16. **Subjekti i interesuar, Komuna Bushat**, ka prapësuar se leja e ndërtimit dhe gjithë aktet e tjera të dhëna në favor të kërkuarit janë konform legjislacionit në fuqi.

17. **Subjekti i interesuar, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër**, ka prapësuar se me shkresën nr. 35, datë 14.5.2004 ajo ka dhënë mendim i cili i është dërguar Ministrisë së Mjedisit për dhënien e lejes mjedisore. Ushtrimi i aktivitetit të kërkuarit nuk bazohet në këtë shkresë, por në lejen mjedisore nr. 331, datë 9.9.2004 të dhënë nga Ministria e Mjedisit. Gjithashtu, Agjencia Mjedisore Rajonale parashtron se me vendimin nr. 431, datë 3.10.2008 të Gjykatës së Apelit Shkodër çështja lidhur me anulimin e shkresës së lartpërmendur është pushuar dhe se ajo nuk është thirrur më në gjykim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin për pezullimin e gjykimit

18. Subjektet e interesuara Ndoc dhe Sinan Molla kanë kërkuar pezullimin e gjykimit deri në shprehjen me vendim përfundimtar të organeve të hetimit, për kallëzimin e paraqitur prej tyre për falsifikim dhe përdorim të falsifikuar të vendimit nr. 5, datë 13.2.2004 të KRT të Komunës Bushat nga ana e kërkuarve. Sipas subjekteve të interesuar ky vendim ka qenë dhe është objekt i gjykimit në gjithë shkallët e gjykimit dhe në alternativën që organi i hetimit do të vendoste se vendimi në fjalë është i falsifikuar, pretendimet e kërkuarve do të jenë haptazi të pabazuara.

19. Pezullimi i gjykimit kushtetues parashikohet nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit Gjykata kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Përgjithësisht, vlerësimi i Gjykatës për të vendosur pezullimin ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë *medio tempore*, para se Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës.

20. Gjithashtu, ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se: “për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr

parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Sipas nenit 297/a të KPC-së, gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative.

21. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se paraqitja e kallëzimit nga ana e subjekteve të interesuara nuk pengon dhe nuk ndikon në zgjidhjen e çështjes pranë kësaj Gjykate si dhe nuk ekziston rreziku që akti në fjalë të prodhojë pasoja të pariparueshme. Për pasojë kjo kërkesë e tyre është e pabazuar.

B. Për themelin e kërkesës

22. Bazuar në nenin 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve për cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Shterimi i mjeteve kërkon që individ të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara. Ai përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuari, përpara se t’i drejtohet Gjykatës. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuari t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 15, datë 19.4.2013; nr. 28, datë 15.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se kërkuarit, për disa nga pretendimet e ngritura, nuk kanë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore, pasi pretendimet nuk janë parashtruar fillimisht në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kjo rrethanë, sipas kërkuarit, ka ndodhur sepse ai dhe mbrojtësi i tij nuk kanë pasur mundësinë të paraqesin një rekurs të “plotë” për shkak të vonesës në zbardhjen e vendimit të Gjykatës së Apelit. Prandaj, Gjykata e sheh me vend që, përpara se t’i japë përgjigje pretendimeve të tjera të kërkuarit, të shqyrtojë fillimisht pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të mosparaqitjes së shkaqeve të plota të ankimit, kundër vendimit të gjykatës së apelit, në rekurs. Gjykata çmon se analiza e këtij pretendimi shërben si kusht paraprak për shqyrtimin apo jo të pretendimeve të tjera të kërkuarve.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

24. Kërkuarit kanë parashtruar se data e zbardhjes së vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nuk u është bërë e ditur dhe se sekretaria gjyqësore ka vepruar në kundërshtim me nenin 476/2 të KPC-së, pasi nuk i ka

kërkuar atyre të bëjnë plotësimet përkatëse në rekursin që kishin paraqitur për zënien e afatit.

25. Nga dosja gjyqësore rezulton se në seancën e datës 03.10.2008, Gjykata e Apelit Shkodër, ka lexuar dispozitivin e vendimit, por nuk rezulton se kur është zbardhur vendimi (i arsyetuar) nr. 431, datë 3.10.2008 i kësaj Gjykate. Ndërkohë, në datë 11.10.2008 kërkuesit kanë paraqitur rekurs për zënien e afatit, meqë deri në atë datë nuk ishte zbardhur akoma arsyetimi i vendimit *de quo*, duke rezervuar të drejtën e paraqitjes së shkaqeve të ankimit në një moment të dytë. Rekursi i plotë nuk është paraqitur asnjëherë nga kërkuesit. Sekretaria gjyqësore e shkallës së parë ka dërguar në datën 15.12.2008 dosjen në Gjykatë të Lartë, pranë të cilës dosja është regjistruar në datën 17.12.2008. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e kërkuesve në dhomë këshillimi në datën 15.12.2011 dhe me vendimin nr. 00-2011-2097, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, pavarësisht se këto shkaqe, të paktën nga kërkuesi, nuk ishin paraqitur të plota.

26. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, gjithashtu, është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim, Gjykata duke marrë në konsideratë harkun e gjatë kohor nga dhënia e vendimit të apelit (2008) deri në marrjen e vendimit të mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë (2011), krijon bindjen se kërkuesit dhe mbrojtësi i tyre kanë pasur të gjitha mundësitë për të kontrolluar dosjen e tyre gjyqësore dhe ecurinë e procesit. Si pasojë, Gjykata vlerëson se mungesa e depozitimit të rekursit të plotë ka ardhur si rezultat i neglizhencës apo mosinteresimit të kërkuesve.

28. Në këto kushte, Gjykata çmon se nuk ka shkelje të së drejtës së aksesit në gjykatë, si element i procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe për këtë arsye ky pretendim i kërkuesve nuk është i bazuar.

29. Në vijim të këtij arsyetimi, Gjykata vëren se i vetmi pretendim i ngritur nga kërkuesit në rekursin (për

zënien e afatit) të depozituar, ka të bëjë me faktin se gjykata e apelit ka anuluar lejen e ndërtimit pa marrë në konsideratë rrethanën se ankimi kundër lejes së ndërtimit është bërë pasi ajo i ka prodhuar efektet e saj. Gjykata konstaton gjithashtu se këtij pretendimi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje. Nga sa më lart (*shih paragrafin 20*), Gjykata, në vijim, do të analizojë vetëm këtë pretendim të kërkuesve.

30. Gjithashtu, në zbatim të parimit *iura novit curia*, sipas të cilit Gjykata nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), kjo Gjykatë vlerëson se çështja që shtrohet për shqyrtim në rastin konkret konsiston në vlerësimin nëse Gjykata e Lartë, duke mos i dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesve mbi vlefshmërinë e lejes së ndërtimit ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit, të sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

31. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata po ashtu ka çmuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo

vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendur. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Gjykata është shprehur edhe lidhur me zbatimin e këtij detyrimi nga Gjykata e Lartë, për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi dhe, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin në shqyrtim, sikurse u përmend dhe më lart, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit Shkodër, për shkak të konstatimit të ndotjes që shkakton aktiviteti i mbarështimit të derrave i ushtruar në objektin e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nr. 5, datë 13.2.2004 të lëshuar nga KRT, pranë Komunës Bushat, me vendimin nr. 431, datë 3.10.2008 ka vendosur anulimin e lejes së lartpërmendur, në një moment kur objekti i ndërtimit kishte përfunduar dhe leja e ndërtimit i kishte prodhuar pasojat e saj. Në këto rrethana kërkesit pretendojnë se kjo ndërhyrje në lejen e ndërtimit nga ana e Gjykatës së Apelit përbën cenim të së drejtës së pronësisë të kërkuësve. Gjykata vlerëson se këtij pretendimi Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje.

36. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i mospranimin të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134,

pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Pranimin pjesërisht të kërkesës¹.

- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar) Vitore Tusha, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuës shoqëria Dizotti sh.p.k. dhe Edoard Rrotani shumica ka arritur në përfundimin se vendimi nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuësve, pasi nuk ka respektuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Shumica ka argumentuar se Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje pretendimit të kërkuësve se Gjykata e Apelit Shkodër, ka vendosur anulimin e lejes së ndërtimit nr. 5, datë 13. 2.2004 të lëshuar nga KR, pranë Komunës Bushat, në një moment kur objekti i ndërtimit kishte përfunduar dhe leja e ndërtimit i kishte prodhuar pasojat e saj, fakt i cili sipas kërkuësve përbën cenim të së drejtës së pronësisë të tyre (*shih paragrafin nr. 35 të vendimit*). Për këtë arsye shumica ka pranuar pjesërisht kërkesën objekt shqyrtimi dhe ka vendosur shfuqizimin e vendimit të lartpërmendur, si të papajtuësishëm me Kushtetutën.

2. Edhe pse jam dakord me argumentet e shumicës, cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër. Gjithashtu, ndryshe nga qëndrimi i shumicës, vlerësoj se rivendosja e të drejtave të kërkuësve, që lidhen me respektimin e parimeve themelore kushtetuese në kuadër të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, bëhet e mundur duke shfuqizuar edhe vendimin nr. 431, datë 3.10.2008, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këto kushte, në vijim po jap arsyet e këtij mendimi paralel.

Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit të mospranimin të rekursit të Gjykatës së Lartë.

¹ Gjyqtari V. Kristo votoi për pranimin tërësisht të kërkesës.

3. Kërkuesit, ndër të tjera, kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe pse në prani të dy vendimeve gjyqësore me qëndrime të ndryshme nga njëri – tjetri, nuk e kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe nuk i dha përgjigje problemeve juridike të ngritura në rekurs. Sipas tij, për këto shkaqe, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e rekursit, është i paarsyetuar.

4. Sikurse ka nënvizuar edhe shumica, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

5. Gjykata po ashtu ka çmuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

6. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendur. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

7. Gjykata, gjithashtu, në rastin e ekzistencës së dy vendimeve të kundërta të gjykatave të faktit, ka theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të pasur një rol aktiv, që shkon

përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuesit. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në të tilla raste (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuesi, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese për shkak të vendimit të mosprimit të rekursit, i cenohet e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

8. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010, nr. 12, datë 14.4.2010, nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (shih vendimet nr. 14, datë 5.7.2005, nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

9. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substancial. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit” (shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010, nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e të drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010, nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

10. Nga sa më sipër, në rastin objekt shqyrtimi, duke qenë se vendimi i gjykatës së apelit ka qenë diametralisht i kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë, me qëllim që kërkuesve t'i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi

gjyqësor të dhënë ndaj tij (në rastin konkret ndaj vendimit të gjykatës së apelit që ka përcaktuar ndalimin e ushtrimit të aktivitetit të mbarështimit të derrave dhe anulimin e lejes së ndërtimit), mendoj se Gjykata e Lartë duhej të shprehej lidhur me themelin e çështjes duke respektuar, në këtë mënyrë, edhe nga pikëpamja substanciale të drejtën e ankimit të kërkuësve.

11. Në këtë këndvështrim, jam i mendimit se është i bazuar dhe duhej pranuar pretendimi i kërkuësve për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në të dyja drejtimit e parashtruara prej tyre, si në aspektin e mosdhënies përgjigje pretendimit të kërkuësve lidhur me vlefshmërinë e lejes së ndërtimit ashtu dhe mosdhënies përgjigje të problemeve me natyrë juridike të krijuara nga vendimarrja diametralisht e kundërt lidhur me themelin e çështjes respektivisht nga gjykata e apelit dhe ajo e shkallës së parë.

12. Si përfundim, vlerësoj se shqyrtimi në themel i çështjes nga Gjykata e Lartë, sipas këndvështrimit të evidentuar më lart, do të bënte të mundur rivendosjen edhe të të drejtave të cenuara që shumica ka konstatuar në vendimin e saj. Në të kundërt, referuar linjës së ndjekur prej saj (lidhur me vlefshmërinë e lejes së ndërtimit), kërkesa duhej pranuar në tërësinë e saj duke kthyer çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër, aty ku është konstatuar fillimisht procesi i parregullt ligjor.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishëm të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka theksuar se për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, atëherë vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*prg. 34 i vendimit*). Bazuar në këtë qëndrim, shumica ka çmuar se Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje pretendimit të kërkuësve për cenimin e të drejtës së pronësisë dhe ka konkluduar se për këtë arsye vendimi i mospranimin të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore (*prg. 35-36 të vendimit*).

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës pasi, në vlerësimin tim, ashtu siç jam shprehur edhe me

mendim pakice në vendimet nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr. 3, datë 23.1.2014, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkuësve në vendimin e saj, të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimin të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 7.12.2011, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

4. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsytuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

5. Nga arsytimi i shumicës nënkuptohet se, në rastin e ngritjes në recurs të pretendimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet t'u japë përgjigje këtyre pretendimeve (*shih prg. 35 të vendimit*). Në një arsytim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në recurs nuk ngrihen pretendime që kanë të bëjnë me shkelje të parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t'u japë përgjigje, pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsytim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsytimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsytimit, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në recurs, është bërë nga

shumica pa parashtruar motivet përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt, në aspektin kushtetues, në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

6. Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar natyrën e pretendimeve të ngritura në të dhe duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs, në dhomë këshillimi. Vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

7. Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjykimit në Gjykatën e Lartë. Në rastin konkret shumica i është shmangur vlerësimit kushtetues të pretendimeve që, në çmuarjen e saj, kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

8. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmoj se në rastin konkret nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesit duhet të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues shoqëria "DIZOTTI" sh.p.k., jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës dhe, për pasojë, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2011-2097, datë 15.12.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

2. Pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura në kërkesë, shumica ka vlerësuar se për disa nga pretendimet e ngritura kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet ligjore, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, pasi nuk ishin ngritur më parë në rekurs dhe se i vetmi pretendim i ngritur në Gjykatën e Lartë ka të bëjë me faktin se gjykata e apelit ka anuluar lejen e ndërtimit, pa marrë në konsideratë rrethanën se ankimi kundër lejes së ndërtimit është bërë pasi ajo i ka prodhuar efektet e saj,

çka sipas kërkuesve ka cenuar të drejtën e tyre të pronësisë. Këtë pretendim shumica e ka trajtuar në këndvështrim të respektimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit, dhe ka arritur në përfundimin se ky standard nuk është përmbushur, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të mësipërm.

3. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tre shkallët e gjykimit, ajo nuk mund të verë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

4. Neni 472 i KPC-së ka parashikuar shkaqet për të cilat mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë, kurse neni 480 i po këtij Kodi parashikon se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i rekursit vendoset nga kolegji në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se, në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 8, datë 2.5.2006; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 4, datë 25.2.2009; nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar edhe se detyrimi për të provuar ekzistencën e shkeljeve të së drejtës për proces të rregullt nga

shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit bie mbi kërkuesin dhe nëse ai nuk arrin ta provojë këtë, atëherë nuk mund të konkludohet se vendimi i dhomës së këshillimit është rezultat i një procesi të parregullt ligjor (*shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit, cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementët përbërës të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, të konstatuar në shkallët e tjera të gjykimit, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit e kthen çështjen në Gjykatën e Lartë në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt, të evidentuara në gjykimin e faktit.

6. Çdo qëndrim i kundërt do të vinte ndesh me qëllimin e ligjit për karakterin parandalues të dhomës së këshillimit, për të kaluar në seancë vetëm ato çështje kur me të vërtetë në rekurs janë ngritur probleme ligjore. Për këtë arsye, vlerësimet që bëjnë kolegji në dhomën e këshillimit, nuk mund të përbëjnë apriori proces të parregullt ligjor dhe të passjellin kurdoherë shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe do ta kthente padrejtësisht Gjykatën Kushtetuese në një instancë më të lartë gjykimi (*shih vendimin nr. 210, datë 27.12.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka vlerësuar se nuk është e mjaftueshme për të kërkuar antikushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor vetëm paraqitja e shkaqeve ligjore në rekurs, por është e domosdoshme që këto pretendime të gjejnë pasqyrim në aktet e çështjes dhe të kenë lidhje të drejtpërdrejta me elementet thelbësorë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 26, datë 1.10.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në një rast të tillë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, rezulton se në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, i vetmi pretendim i paraqitur nga kërkuesit është ai që

lidhet me faktin se gjykata e apelit ka anuluar lejen e ndërtimit, pa marrë në konsideratë rrethanën se ankimi kundër lejes së ndërtimit është bërë pasi ajo i ka prodhuar efektet e saj, si dhe pa konstatuar mangësi në dhënien e kësaj lejeje. Në vendimin e saj, shumica shprehet se kërkuesit pretendojnë se kjo ndërhyrje në lejen e ndërtimit, nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër, përbën cenim të së drejtës së tyre të pronësisë dhe, për pasojë, Gjykata e Lartë duhet t'i jepte përgjigje këtij pretendimi.

8. Gjykata ka theksuar se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Për sa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objektin e kontrollit për këtë Gjykatë, sepse ajo mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 37, datë 19.9.2011*). Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, pretendimi i ngritur nga kërkuesit lidhet me çështje të vlerësimit të provave në gjykimin e faktit. Ai përfshin vlerësime që lidhen me çështje të themelit, konkretisht me afatin e lejes së ndërtimit dhe pasojat e ardhura prej saj, të cilat nuk mund të bëhen objekt i gjykimit kushtetues dhe, për pasojë, ky pretendim duhet të ishte rrëzuar nga Gjykata.

9. Për më tepër, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit, e Gjykatës së Lartë, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se interpretimi që ka bërë gjykata e apelit, i cili është ai që kundërshtohet në rekurs, është i drejtë, është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e rekursit. Bazuar në standardet e mësipërme vlerësoj se, edhe në rastin konkret, për sa Gjykata e Lartë ka vlerësuar mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se shkaqet e ngritura në të nga kërkuesit, që janë servirur si shkaqe ligjore për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj dhe as në materialet e çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, ka realizuar një proces vlerësimi të atyre shkaqeve, nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur

në dispozitiv, për mospranimin e tij. Fakti që kërkuesit e lidhin pretendimin e tyre me të drejtën e pronësisë, nuk e legjitimon Gjykatën të shfuqizojë vendimin e Gjykatës së Lartë, për sa kohë që nuk ka mundur të evidentojë, ajo vetë, cenim të standardeve të procesit të rregullt, apo qoftë edhe të kësaj të drejte substanciale të individit, të pretenduar të cenuar (e drejta e pronësisë). Në këto kushte, vlerësoj se, një qëndrim të tillë i Gjykatës përbën një tejkalim të kompetencave të saj, duke marrë ato që i përkasin dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë, por edhe një devijim nga jurisprudenca e saj e konsoliduar.

10. Në lidhje me detyrimin për arsyetimin e vendimeve të dhomës së këshillimit që vendosin mospranimin e rekursit, Gjykata dhe GJEDNJ-ja kanë vlerësuar se ky lloj arsyetimi i vendimit të dhomës së këshillimit nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në këtë drejtim. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 35, datë 5.3.2002 të Gjykatës Kushtetuese*). GJEDNJ-ja vëren, gjithashtu, se arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të vendimeve de plano, tregon se kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë nga shkaqet ligjore të parashikuar në dispozitat përkatëse ligjore, çka përbën një kërkesë pranueshmërie për ankimin. GJEDNJ-ja vëren se aty ku një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje mbi bazën se nuk ka shkaqe ligjore një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së (*vendimet e GJEDNJ-së në çështjen Marini v. Shqipërisë, datë 7 korrik 2008, § 106; në çështjen Mishgjoni v. Shqipërisë, datë 7 dhjetor 2010, § 51*). Në kuptim të respektimit të standardit kushtetues për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, kjo praktikë e Gjykatës së Lartë, e arsyetimit të vendimeve të saj të dhomës së këshillimit në formulën e tyre de plano, përfaqëson një standard minimal të vendosur prej saj, me qëllim të rritjes së efektivitetit të gjykimit në këtë gjykatë.

11. Në përfundim të analizës së mësipërme, vlerësoj se, për arsye se nga procesi gjyqësor, në tërësi, nuk rezulton cenimi i standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM
Nr. 38, datë 30.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | anëtar i | “ | “ |
| Sokol Berberi | anëtar i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | “ | “ |
| Gani Dizdari | anëtar i | “ | “ |
| Fatos Lulo | anëtar i | “ | “ |
| Vitore Tusha | anëtare e | “ | “ |

me sekretare Blerina Basha (Çinari), në datën 15.4.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Pal Bardhi

SUBJEKTE TË INTERESUAR: Skënder Spahiu, Zejnel Spahiu, Ekrem Spahiu, Sahit Spahiu (trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit Gafurr Spahiu), Lekë Shkoza, Bashkia Laç.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Laç, Kurbin.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimeve nr. 1167/976, datë 29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; nr. 336, datë 25.02.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2012-953, datë 25.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha; mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuesi, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit i është njohur e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen 17670 m² me vendimin nr.38, datë 23.2.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Laç. KKKP-ja ka vendosur, gjithashtu, t'i kthejë kërkuesit në natyrë 5000 m² truall i lirë, duke caktuar dhe grupin prej tri ekspertësh për caktimin në vend të kufizimeve përkatëse, ndërsa për pjesën e mbetur 12670 m² ka vendosur kompensimin në letra me

vlerë. Vendimi i KKKP-së, në pikën 4 ka përcaktuar se pronarët që kanë ndërtuar në pronat e ish-pronarit (*ku listohet me nr. rendor 1 lokali bar-bufe 140 m² i personit të interesuar Gafurr Spahiu me 140m²*), detyrohen të lidhin kontratë qiraje ose të riblejnjë truallin. Ky vendim është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, në datën 12.11.2002.

2. Sipas kërkesit, nga sipërfaqja prej 5000 m² që duhet t'i kthehej në natyrë, 625 m² ishte zënë fillimisht nga shtetasi Gafurr Spahiu, i cili kishte ndërtuar Lokal-Bar-Bufe, sipas lejes së ndërtimit të dhënë nga KRRT-ja e Këshillit të Rrethit Laç, më datë 2.2.1993. Në datën 19.7.1994, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Laç ka vërtetuar gjyqësisht faktin e pronësisë për pasurinë Lokal-Bar-Bufe (dhe një garazh) duke e njohur atë pronar.

4. Në datën 20.1.1995, Gafurr Spahiu ka lidhur me Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Laç kontratën e qirasë për truallin 140 m². Në datën 24.12.1998 sipërfaqja në fjalë është regjistruar në ZRPP. Në vitin 2003, bazuar në vendimin nr. 49, datë 5.9.2003 të Këshillit Bashkiak "Për shitjen e trojeve", ai ka përfutur truallin prej 625 m². Në datën 17.3.2004, Gafurr Spahiu e ka tjetërsuar sipërfaqen prej 625 m² përmes kontratës së shitjes të lidhur me shtetasin Lekë Shkoza, i cili e ka regjistruar pronën po atë ditë në ZRPP.

4. Këshilli Bashkiak Laç, mbi kërkesën e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe të disa ish-pronarëve, me vendimin nr. 18, datë 30.3.2004 vendosi shfuqizimin e vendimit të shitjes së trojeve të vitit 2003, me arsyetimin se: "1...nuk është në përputhje me disa vendime të KKKP-së. 2. Ngarkohet seksioni i urbanistikës të bëjë saktësimin e pronave publike të bashkisë".

5. Kërkuesi duke pretenduar se subjektet e interesuar i kanë cenuar të drejtat pronësore, në vitin 2004 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesë padi me objekt "Pavlefshmërinë e veprimeve juridike të kontratave të shitblerjes nr. 957 kol, datë 15.09.2003 të lidhura midis Bashkia Laç (shitësi) dhe Gafurr Spahiu (blerësi); nr. 159 kol, datë 17.3.2004 midis Gafurr Spahiu (shitësi) dhe Lekë Shkoza (blerësi)"; çregjistrim veprimesh hipotekore; sigurim padie". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 465, datë 26.11.2004 ka vendosur rrëzimin e padisë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 857, datë 28.6.2007 ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 1167/976, datë 29.12.2008 ka vendosur: "Rrëzimin e kërkesë-padisë".

8. Mbi ankimin e kërkesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 336, datë 25.2.2010 ka vendosur: "Lënie në fuqi të vendimit nr. 1167/976, datë

29.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin".

9. Mbi bazën e rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2012-953, datë 25.4.2012, në dhomë këshillimi, ka vendosur: "Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Pal Bardhi, kundër vendimit nr. 336, datë 25.2.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë."

II

10. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në aspektet e mëposhtme:

10.1 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi gjykatat analizojnë situatën faktike të problemit, pra nëse është kthyer apo jo fizikisht trualli dhe jo pretendimet e parashtruara në kërkesë padi në lidhje me pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit dhe të kontratave të shitjes, si akte të cilat kanë cenuar interesat e ligjshme pronësore të kërkesit.

10.1.1 Përfundimi në të cilin ka arritur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, se paditësi i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e padisë, pasi mungon vendimi i marrë nga organi kompetent për kthimin fizik të sendit, është i pabazuar. Interesi i ligjshëm ka të bëjë me zgjidhjen e konfliktit të krijuar nga fakti se sipërfaqja prej 5.000 m², e kthyer në natyrë nga KKKP-ja dhe regjistruar në vitin 2002 në ZVRPP Kurbin, sipas akt ekspertimit të realizuar nga vetë Gjykata, ka mbivendosje me pronën e Gafurr Spahiut të tjetërsuar më pas në favor të Lekë Shkozës.

10.1.2 Edhe Gjykata e Apelit Tiranë arrin në përfundim të gabuar kur shprehet se: "vendimi i KKKP-së është në kundërshtim me ligjin për faktin se sipërfaqja prej 5.000 m² nuk mund të përcaktohej në një fazë të dytë me ekspertë të ngarkuar nga ky komision, por duhet të ishte ai që të përcaktonte këtë sipërfaqe dhe kufizimet përkatëse" ose "vendimi i KKKP-së është me të meta thelbësore të cilat e bëjnë atë të pavlefshëm dhe pa u ndrequr këto të meta paditësi nuk legjitimohet të ngrejë pretendime dhe të ketë të drejta".

10.2 Është cenuar e drejta e mbrojtjes në drejtim të barazisë së armëve dhe të drejtës për t'u dëgjuar, pasi Gjykata e Apelit, pa e shtruar për diskutim midis palëve çështjen e vlefshmërisë së vendimit nr. 38, datë 23.2.1995 të KKKP-së Laç, arrin në përfundimin se është i pavlefshëm, duke i mohuar kërkesit mundësinë e arsyeshme për të paraqitur argumentet në lidhje me këtë fakt.

10.3 Po ashtu, është cenuar edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Apelit, duke shfuqizuar vendimin e KKKP-së Laç, ka tejkaluar kompetencat lëndore.

10.4 Është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat i kanë dhënë fuqi prapavepruese ligjit nr. 7693/1993 “Për Urbanistikën” duke e njohur si të ligjshme lejen e lëshuar nga një organ katër muaj përpara krijimit të tij. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë nuk mund të vinte në dyshim vlerën e vendimit nr. 38, datë 23.2.1995 të KKKP-së Laç, pasi ky nuk përbën një akt administrativ, por një vendim *quasi* gjyqësor.

10.5 Është cenuar *standardi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore*, pasi gjykatat e dy shkallëve të para nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi në lidhje me: (i) pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të datës 2.2.1993 nga KRRT-ja, organ që nuk ekzistonte në atë kohë; (ii) pavlefshmërinë e kontratës së qirasë të datës 20.1.1995 lidhur midis të paditurit Gafurr Spahiu dhe Komitetit Ekzekutiv, organ inekzistent në atë kohë; (iii) fuqinë provuese të vendimit nr. 49, datë 5.9.2003 të Këshillit Bashkiak Laç, i cili nuk është miratuar nga Prefekti, kurse pika 1 mbi shitjen e trojeve është shfuqizuar në vitin 2004.

10.6 Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë është cenuar e drejta e ankimit dhe e aksesit, pasi shkaqet e parashtruara në rekurs kishin të bënin me zbatimin e gabuar të ligjit dhe shkelje procedurale, dhe si të tilla çështja duhet të kalonte për shqyrtim në seancë plenare dhe jo të vendosej mospranimi në dhomë këshillimi.

11. **Subjektet e interesuara**, trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit Gafurr Spahiut, kanë prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

11.1. Pretendimi i kërkuarit në lidhje me cenimin e aksesit në gjykatë si rezultat i moslegjitimit aktiv nga gjykata është i pabazuar, pasi ky arsyetim provon mungesën e interesit të ligjshëm në ngritjen e padisë, por nuk i ka mohuar ushtrimin e kësaj të drejte. Kërkuari është pranuar si palë paditëse në procesin civil, i cili ka kaluar të gjitha fazat duke përfunduar me vendimin objekt kundërshtimi.

11.2. Edhe pretendimi mbi cenimin e të drejtës së mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së është çështje e vlerësimit të fakteve nga gjykata.

11.3. Gjithashtu i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike si rezultat i mospërcaktimit nga gjykatat të ligjit të zbatueshëm për dhënien e lejes së ndërtimit. Edhe përcaktimi nga ana e kërkuarit të vendimeve të KKKP-së si *quasi* gjyqësore është i pabazuar, pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka përcaktuar këtë vlerë të tyre ndonëse ka vlerë të përgjithshme nuk ka fuqi prapavepruese ndaj vendimeve të dhëna, siç është edhe ai i Gjykatës së Apelit.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi tjetër i kërkuarit në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore si rezultat i mosdhënies përgjigje të pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi. Për sa kohë pretendimet e kërkuarit janë bërë objekt i analizës gjyqësore, argumentet mbi pjesë të shkëputura të vendimeve gjyqësore i paragjykojnë ato.

11.5. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së ankimit dhe aksesit në Gjykatën e Lartë, subjektet e interesuar prapësojnë se kjo përbën një veprimtari normale të dhomës së këshillimit, në rast se krijon bindjen që faktet e parashtruara në rekurs nuk gjëjnë mbështetje në materialet e çështjes.

12. Subjekti i interesuar, Lekë Shkoza, ka prapësuar me shkrim si vijon:

12.1 Pretendimet e parashtruara nga kërkuari janë analizuar e gjykuar në tri shkallët e gjykimit, nga të cilat është konkluduar për pabazueshmërinë e tyre. Mospranimi i rekursit të paraqitur nga kërkuari konfirmon mungesën e shkeljeve procedurale që mund të kishin ndikuar në dhënien e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi.

12.2 Kërkuari ka regjistruar pronën e njohur me vendim të KKKP-së Laç në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, fakt i cili është konstatuar edhe nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe grupi i kontrollit tekniko-ligjor të ZQRPP Tiranë, të cilat kanë kërkuar fshirjen e mbivendosjes së krijuar me pasurinë e regjistruar në emër të të paditurit Gafurr Spahiu, e cila nëpërmjet kontratës së shitjes i ka kaluar Lekë Shkozës.

12.3 Të pabazuara janë edhe pretendimet mbi të cilat kërkuari argumenton cenimin e aksesit në gjykatë. Regjistrimi i objektit Bar-Bufe në ZRPP është i vlefshëm, pasi edhe pse bazohet në vendimin gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik, data e regjistrimit është përpara hyrjes në fuqi të KPC-së, që e konsideron të pavlefshëm këtë lloj regjistrimi.

12.4 Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të KKKP-së nga Gjykata e Apelit është i drejtë, pasi mungesa e hartës treguese të vendndodhjes së pronës është e vitit 2002, kurse vendimi KKKP-së i vitit 1995, dhe në këtë kuptim, mungesa e këtij elementi përbën një të metë thelbësore të vendimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

13. Kërkuari ka pretenduar se në procesin e rigjykimit të çështjes, gjykatat e dy shkallëve të para analizojnë vetëm situatën faktike të problemit, nëse është kthyer apo jo fizikisht trualli dhe jo pretendimet e parashtruara në kërkesë padi në lidhje me pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit dhe të kontratave së shitjes, si akte të cilat kanë

cenuar interesat e tij të ligjshme pronësore. Sipas tij, arsyetimi i gjykatave se paditësit i mungon interesi i ligjshëm për ngritjen e padisë, pasi mungon vendimi i marrë nga organi kompetent për kthimin fizik të sendit, është i pabazuar dhe, për rrjedhojë, i cenon të drejtën e aksesit në gjykatë.

14. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se procesi i rregullt ligjor ka si element përbërës, midis të tjerash, edhe të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimin nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur, gjithashtu, se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Mostrajtimi i mjetit procedural në mënyrë substanciale cenon të drejtën e mbrojtjes të të gjykuarit dhe njëkohësisht aksesin e tij në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 21, datë 24.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në përputhje me këtë, Kodi i Procedurës Civile, në nenin 31, e përkufizon padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që bën pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (*shih vendimin nr. 5, datë 20.3.2006*).

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyr në ato raste kur përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin,

faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vështrim të sa më sipër, rezulton se në kuadër të kontrollit që Gjykata Kushtetuese ushtron në zbatim të nenit 131/f të Kushtetutës, çështjet e interpretimit të ligjit hyjnë në juridiksionin kushtetues vetëm nëse dhe për aq sa ky interpretim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

18. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkuesi jo vetëm e ka ushtruar lirisht dhe pa pengesa të drejtën e ngritjes së padisë duke parashtruar pretendimet përkatëse, por padia e tij është marrë në shqyrtim si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Gjykata vëren gjithashtu se argumentet e parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë kanë të bëjnë më çështje të interpretimit të ligjit dhe të vlerësimit të provave, dhe si të tilla ato i takojnë juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

19. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit dhe të gjykatës së caktuar me ligj

20. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se Gjykata e Apelit, pa e shtruar për diskutim midis palëve çështjen e vlefshmërisë së vendimit nr. 38, datë 23.2.1995 të KKKP-së Laç, arrin në përfundimin se është i pavlefshëm, duke i mohuar kërkuesit mundësinë e arsyeshme për të paraqitur argumentet në lidhje me këtë fakt. Po ashtu, Gjykata e Apelit, duke shfuqizuar vendimin e KKKP-së Laç, ka tejkaluar kompetencat lëndore, duke shkaktuar edhe cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

21. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e

njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 12.6.2003; nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 18, datë 23.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011; nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vështrim të standardit të mësipërm si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e gjykatës së apelit.

24. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin të drejtës për t'u mbrojtur, barazisë së armëve, kontradiktoritetit dhe gjykatës së caktuar me ligj janë të pabazuara.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

25. Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se gjykatat e zakonshme i kanë dhënë fuqi prapavepruese ligjit nr. 7693/1993 "Për Urbanistikën" duke e njohur si të ligjshme lejen e lëshuar nga një organ katër muaj përpara krijimit të tij. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë nuk mund të vinte në dyshim vlerën e vendimit nr. 38, datë 23.2.1995 të KKKP-së Laç, pasi ky nuk përbën një akt administrativ, por një vendim *quasi* gjyqësor. Sipas kërkuesit, duke vepruar në këtë mënyrë, gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike.

26. Jurisprudenca kushtetuese konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti i referon te parimi i shtetit të së drejtës. Për sa i përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është

shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt" përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 29.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu referuar vendimeve objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se gjykatat i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit në lidhje me lejen e ndërtimit, duke argumentuar se: "... lidhur me dyshimet e palës paditëse mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e "lejes së ndërtimit" ... gjatë këtij procesi gjyqësor nuk u arrit të provohet apo argumentohet me prova bindëse "falsiteti i lejes së ndërtimit". Gjithashtu, nga pala paditëse në asnjë moment të këtij gjykimi nuk u kërkua "goditja për falsitet" e asnjë akti në shqyrtim ..."

28. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se dhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret lidhet gjithashtu me procesin e të provuarit dhe me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, dhe, si i tillë, edhe ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

D. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

29. Sipas kërkuesit, gjykatat e dy shkallëve të para nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në kërkesë padi në lidhje me: (i) pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të datës 2.2.1993 nga KRRT-ja, organ që nuk ekzistonte në atë kohë; (ii) pavlefshmërinë e kontratës së qirasë të datës 20.1.1995 lidhur midis të paditurit Gafurr Spahiu dhe Komitetit Ekzekutiv, organ inekzistent në atë kohë; (iii) fuqinë provuese e vendimit nr. 49, datë 05.09.2003 të Këshillit Bashkiak Laç, i cili nuk është miratuar nga Prefekti, kurse pika 1 mbi shitjen e trojeve është shfuqizuar në vitin 2004.

30. Gjykata, paraprakisht, konstaton se kërkuesi ka parashtruar në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë vetëm pretendimin në lidhje me pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit, ndërkohë që mungojnë argumente në lidhje me dy pretendimet e tjera.

31. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 36 datë 10.11.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të

përbushet nga individi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'i jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 15, datë 19.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit që lidhen me cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit nuk janë ngritur më parë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe në këtë vështrim, kërkuari nuk legjitimohet të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për këto dy pretendime.

33. Për sa i përket pretendimit në lidhje me pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit, Gjykata, bazuar edhe në përfundimet mbi moscenimin e parimit të sigurisë juridike (§ 27), vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

E. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë

34. Sipas kërkuarve, Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, ka cenuar të drejtën e ankimit efektiv, të drejtën për t'u dëgjuar si dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Edhe pse kërkuarit parashtronin në rekurs shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa u shprehur për shkaqet konkrete të mosprimit.

35. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se "kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe". Në jurisprudencën e kësaj Gjykate, e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010; nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 14, datë 26.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale, është pjesë e të drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që

një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Nga rrethanat e çështjes konkrete rezultojnë se kërkuari ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, që la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-953, datë 24.4.2012, vendosi mospranimin e rekursit, në dhomë këshillimi.

38. Bazuar në standardet kushtetuese mbi të drejtën e ankimit efektiv, karakteristikat e procesit të shqyrtimit paraprak të rekursit nga Kolegji Civil, në dhomë këshillimi, në mungesë të palëve dhe, po ashtu, në referim të rrethanave të çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuari ka pasur në dispozicion mjetin procedural të rekursit në Gjykatën e Lartë, të cilin e ka ushtruar pa asnjë pengesë, duke parashtruar pretendimet e tij në lidhje me mosrespektimin e elementëve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset gjyqësore të zhvilluara në shkallët më të ulëta të gjykimit, për të cilat kanë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

39. Vendimi i dhënë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi Kolegji i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile dhe nuk ka marrë atribut që i takojnë seancës gjyqësore. Nga ana tjetër, edhe arsytimi i këtij vendimi nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë negativisht në këtë drejtim. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mosprimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit.

40. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e të drejtës së ankimit efektiv, të aksesit, dhe të standardit të arsytimit, gjatë procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, janë të pabazuara.

41. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuari për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë të pabazuara dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.²

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

Anëtarë pjesërisht kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 39, datë 30.6.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i “ “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i “ “ |
| Fatos Lulo | anëtar i “ “ |
| Vitore Tusha | anëtare e “ “ |

me sekretare Blerina Basha (Çinari), në datën 13.11.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare me dyer të hapura, çështjen nr. 45/17 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUAR: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga znj. Arjeta Çefa dhe z. Bledar Miloti, Këshilli i Ministrave, në mungesë,

Ministria e Financave, përfaqësuar nga znj. Arminda Murrizi, znj. Saida Turubani, znj. Isida Koka dhe z. Gentian Çeçe, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 109/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim kërkesën e Gjykatës së Apelit Tiranë, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe prapësimet e subjekteve të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Financave, që kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim “DRT”), në vitin 2010, ka ushtruar kontroll tatimor në veprimtarinë e subjektit tatimpagues “Grupi Industrial Albanez” sh.p.k. (në vijim “subjekti tatimpagues”), person juridik që ka për objekt të veprimtarisë blerjen, shitjen, shkëmbimin e pasurive të paluajtshme, marrjen dhe dhënien me qira e nënqira të pasurive të paluajtshme, marrjen përsipër, mbajtjen dhe administrimin e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, etj. Kontrolli ka pasur për objekt vetëdeklarimet, llogaritjen dhe derdhjen e detyrimeve për TVSH-në, sigurimet shoqërore, etj. për periudhën kohore janar 2006 - dhjetor 2009.

2. Me aktin nr. 6501/8, datë 4.6.2010 “Njoftim vlerësimi për detyrimet” DRT - ja i ka komunikuar subjektit tatimpagues detyrimet përkatëse, ku renditen detyrimi për uljen e gjendjes kreditore për TVSH-në për periudhat shtator-dhjetor 2009 për shkak të kreditimit të gabuar të TVSH-së, si dhe një gjobë në shumën 50 000 lekë për mosmbajtje të saktë të dokumentacionit.

3. Subjekti tatimpagues ka ushtruar ankim kundër aktit “Njoftim vlerësimi për detyrimet” pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DAT”), e cila me vendimin nr. 10225, datë 5.11.2010 ka vendosur: “Shfuqizimin e aktit administrativ, objekt ankimi “Njoftim vlerësimi tatimor për detyrimet” nr. 6501/8, datë 4.6.2010 për uljen e gjendjes kreditore të TVSh-së për periudhat 2009/09 për shumën 5.546.443 lekë; 2009/10 për shumën 3.881.942 lekë; 2009/11 për shumën 8.276.337 lekë; 2009/12 për shumën 12.553.615 lekë. Lënien në fuqi të aktit administrativ objekt ankimi për gjobën për kontabilitetin për vitin 2009 në shumën 50.000 lekë”.

4. Kundër vendimit të DAT ka ushtruar ankim DRT, e cila i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë padi me objekt “Anulimin e pjesëshëm të vendimit nr. 10225, datë 5.11.2010 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për pikat 1, 2, 3,4 të këtij vendimi”. Sipas argumenteve të parashtruara nga DRT-ja në kërkesë padi, subjekti tatimpagues ka kredituar padrejtësisht TVSH në blerje në shumën 30.249.637 lekë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH”, që përcakton: “kreditimi i tatimit nuk lejohet në

² Kryetar B. Dedja dhe gjyqtar F. Hoxha votuan pjesërisht kundër me argumentin e shfuqizimit vetëm të vendimit të Gjykatës së Lartë, kurse gjyqtare V. Tusha votoi edhe për shfuqizimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

asnjë rrethanë për shpenzime që nuk janë tërësisht vetëm për qëllime të veprimtarisë ekonomike”. Në këtë proces gjyqësor subjekti tatimpagues ka ndërhyrë me cilësinë e personit të tretë, duke bashkuar interesat me palën e paditur, DAT.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6877, datë 2.7.2012 ka vendosur pranimin e kërkesë - padisë, duke anuluar pjesërisht vendimin nr. 10225, datë 5.11.2010 të Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke arsyetuar se: “G.I.A, përveç këtij investimi në infrastrukturë është pajisur edhe me leje shesh ndërtimi dhe leje ndërtimi nga KKRT-ja e Komunës Kashar edhe për objekte tregtare, pjesë e studimit urbanistik të zonës në perëndim të qytetit të Tiranës. Nëse objekti (rrugë) do të ishte në funksion vetëm të veprimtarisë ekonomike të G.I.A, atëherë Komuna Kashar nuk do të merrte përsipër pagimin e detyrimeve tatimore për llogari të këtij objekti (pika 4/3 e marrëveshjes midis palëve)”

6. Kundër vendimit të mësipërm, subjekti tatimpagues G.I.A, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Po ashtu, apeluesi, ka kërkuar pezullimin e procesit gjyqësor dhe referimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, kërkesë e cila gjendet e administruar në dosjen gjyqësore.

II

7. **Kërkuesi**, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e ndërmjetëm nr. 1909 regj, datë 11.1.2013, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes civile dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 109/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se:

7.1 Neni 109/3 i ligjit, i cili lejon që organi më i ulët të ankimojë gjyqësisht vendimet e një organi tjetër shtetëror, me hierarki më të lartë administrative, bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi cenon thelbin e të drejtës për t’u drejtuar gjykatës për mbrojtjen e një interesi të ligjshëm të cenuar nga administrata publike. E drejta e ankimit, në rrugë gjyqësore, të akteve administrative është tagër absolut i individit të cenuar nga një akt i paligjshëm dhe i padrejtë i administratës publike.

7.2 Rregullimi ligjor i parashikuar në nenin 109/3 është një anomali që nuk konstatohet në fusha të tjera të së drejtës administrative, që suprimon tërësisht mundësinë e subjektit të interesuar për të vepruar gjyqësisht, pasi e drejta për t’ju drejtuar gjykatës transferohet nga pala private tek organi shtetëror që ka nxjerrë aktin. Në këtë kuptim, pala private e ka të pamundur të rivendosë interesat e shkelura, të cilat

përbëjnë thelbin e mosmarrëveshjes civile dhe një gjendje e tillë mund të zgjasë për një afat të pacaktuar.

7.3 Drejtoria e Apelit Tatimor nuk duhet ngatërruar me një organ *quasi* gjyqësor, pasi nuk ka në përbërje të saj funksionarë të emëruar nga legjislativi, me mandat dhe të palëvizshëm nga funksioni që ata kryejnë. Përkundrazi, Drejtori i Drejtorisë së Apelit është nomenklaturë e Ministrisë së Financave dhe, në këtë kuptim, vendimet e tij lehtësisht mund të shfuqizohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ose Ministri i Financave. Pavarësisht pavarësisë të DAT në vendimmarrje, kjo nuk do të thotë se vendimet e saj kanë vlerën e vendimeve gjyqësore dhe, si të tilla, duhet të ankimohen detyrimisht në gjykatë.

7.4 Rregullimet ligjore të parashikuara në nenet 109 dhe 110 të ligjit bien ndesh edhe me parimin e proporcionalitetit, pasi interesi publik, i cili përbën dhe *ratio legis* për kontrollin paraprak administrativ, nuk ekziston më në momentin që një organ shtetëror ankimon vendimin e marrë nga një organ tjetër shtetëror. Në këtë kuptim, ankimi ndaj vendimit të DAT cenon rëndë një interes të ndryshëm publik siç është ai i sanksionuar në parimin e efikasitetit dhe të miradministrimit të administratës publike, në kuptim të nenit 16 të KPA-së.

7.5 Nisur nga fakti se DAT është një organ i administratës qendrore tatimore, që shqyrton ankimin kundrejt vendimeve të organeve periferike, konstatohet lehtësisht se kemi të bëjmë me një organ epror kundrejt një organi vartës. Për rrjedhojë, parashikimi ligjor vjen në kundërshtim me natyrën hierarkike të organizimit të pushtetit ekzekutiv, duke cenuar për rrjedhojë shtetin e së drejtës. Po ashtu, normat ligjore, të miratuara me shumicë të thjeshtë, nuk respektojnë parimet e sanksionuara në ligje të përforuara si Kodi i Procedurës Civile (nenet 324-325), ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Kodi i Procedurave Administrative (nenet 10, 18, 121, 124), duke cenuar, për rrjedhojë, parimin e hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës.

8. **Subjektet e interesuara kanë paraqitur me shkrim prapësimet e mëposhtme:**

A. Ministria e Financave

8.1 Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor, bazuar në elementët e parashikuar në nenin 109/3, të tillë si përmbajtja, arsyetimi, e drejta për t’u ankuar, është një akt administrativ. Si i tillë, në kuptim të nenit 137/1 të KPA-së, ky vendim mund të ankimohet nga çdo palë e interesuar. Ligjvënësi, në referim të nenit 4 të KPA-së, e ka përcaktuar termin “palë e interesuar” si çdo person fizik ose juridik ose autoritet shtetëror, të drejtat ose kompetencat e të cilit ka të ngjarë të preken gjatë procedurës administrative. Në këtë kuptim,

Drejtoria Rajonale Tatimore ka të drejtë të paraqesë ankim kundër aktit administrativ, vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor, brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

8.2 Pretendimi mbi cenimin e të drejtës së aksesit, është i pabazuar pasi kjo e drejtë nuk është absolute, për më tepër kur natyra e detyrimeve është e tillë që kërkon balancimin e të drejtës së shtetasit për akses efektiv në gjykatë, nga njëra anë dhe interesit të shtetit për të vjelë në mënyrë efektive detyrimet. Subjekti tatimpagues, në çdo rast, ka të drejtë të marrë pjesë në procesin gjyqësor dhe të parashtojë argumente ligjore, ashtu siç ka ndodhur edhe në rastin konkret.

8.3 Drejtoria e Apelit Tatimor, pavarësisht se është strukturë në përbërje të administratës tatimore, ajo është e pavarur në vendimmarrjen e saj. Në këtë kuptim është i pabazuar pretendimi se në rast konflikti midis dy strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, vendimet përkatëse mund t'i shfuqizojë apo lërë në fuqi Ministri i Financave pa qenë e nevojshme që çështja të paraqitet në gjykatë.

8.4 Ligji parashikon hallkën tatimore, pra organin administrativ, ku duhet të kalojë procesi i ankimit përpara se çështja të kalojë në gjykatë dhe, po ashtu, vetë ligji parashikon nëse organi epror ka kompetencë për ta shfuqizuar një akt të strukturës së tij vartëse apo kjo vendimmarrje është e pavarur dhe mund të ankimohet vetëm në gjykatë.

8.5 Edhe në referim të praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë (vendimet nr. 3/2008 dhe nr. 1/2010) arrihet në përfundimin se "... ndërsa ndjekja e rrugës administrative i shërben uniformitetit të veprimtarisë administrative dhe sigurisë juridike...në çdo rast pavarësisht nëse parashikohet apo jo shprehimisht në ligjin e posaçëm, pas dhënies së vendimit nga organi a organet administrative të ngarkuara nga ligji, pala që kishte ushtruar ankimin administrativ, ka të drejtën t'i drejtohet rrugës gjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative...", "janë gjykatat e zakonshme ato që shqyrtojnë zbatueshmërinë e parimeve të procesit të rregullt ligjor nga ana e administratës shtetërore, si në nxjerrjen e aktit administrativ ashtu dhe gjatë procedurës së kundërshtimit të këtij akti në rrugë administrative e të kundërshtuar në një gjykim individual..."

8.6 Po ashtu, në referim të neneve 1 dhe 2 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "pasia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet pas shterimit të ankimit administrativ", duke përjashtuar nga ky rregull rastet "... (b) "kur ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj aktit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë" siç është edhe rasti konkret.

B. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve:

8.7 Drejtoria Rajonale Tatimore është një strukturë administrative me personalitet juridik të mëvetëm, e angazhuar drejtpërdrejt në administrimin dhe vjeljen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesve të regjistruar pranë saj. Kurse Drejtoria e Apelit Tatimor, në referim të nenit 18 të ligjit 9920/2008, është në përbërje të administratës tatimore qendrore, por në asnjë rast nuk është strukturë eprorë e Drejtorisë Rajonale Tatimore. DAT-i është organ i pavarur në vendimmarrje, drejtori i së cilës emërohet nga Ministri i Financave. Objekt shqyrtimi nga DAT, në referim të nenit 108/3 të ligjit, është ligjshmëria e çdo detyrimi tatimor apo vendimi që ndikon në detyrimet tatimore të tatimpaguesit.

8.8 Anulimi i një detyrimi tatimor të përlogaritur prej DRT-së nga një strukturë vendimmarrëse si DAT-i, cenon interesin e ligjshëm të DTR-së, që në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk mund të jetë i paankimueshëm. Ndërhyrja e organeve eprorë si Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve apo Ministri i Financave nuk mund të angazhohen në zgjidhjen e konfliktit, pasi kjo do të cenonte pavarësinë e vendimmarrjes së DAT-it.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Mbi legjitimitimin e kërkuases³

9. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tij.

10. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: së pari, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, duhet të parashtojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje

³ Gjyqtaret V.Tusha dh A.Xhoxhaj votuan kundër legjitimitimit të gjykatës referuese

çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 6, datë 17.2.2012; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykata referuese i ka plotësuar kërkesat si më sipër, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm, lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitës ligjore që kundërshtohet dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së themelit si dhe duke parashtruar arsyet për jokushtetutshmërinë e ligjit, referuar në normat dhe parimet konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht, gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me kërkimin për kontroll incidental të dispozitës ligjore, objekt shqyrtimi.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

12. Gjykata referuese ka pretenduar se neni 109/3 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" (në vijim "ligji nr. 9920/2008"), që parashikon se: "*Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja dëgjimi*", cenon thelbin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e një interesi të ligjshëm të cenuar nga administrata publike. Sipas kërkueses, e drejta e ankimit, në rrugë gjyqësore, të akteve administrative është tagër absolut i individit të cenuar nga një akt i paligjshëm dhe i padrejtë i administratës publike, por parashikimi ligjor i nenit 109/3 e suprimon tërësisht të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, pasi kjo e drejtë transferohet, për një afat të pacaktuar, nga pala private tek organi shtetëror që ka nxjerrë aktin. Gjithashtu, gjykata referuese ka pretenduar se kompetenca e DAT për të shqyrtuar ankimin kundrejt vendimeve të Drejtorisë Rajonale Tatimore, konfirmon raportin e varësisë hierarkike midis një organi epror kundrejt një organi vartës. Për rrjedhojë, parashikimi ligjor vjen në kundërshtim me natyrën hierarkike të organizmit të pushtetit ekzekutiv dhe cenon rëndë parimin e efikasitetit dhe të miradministrimit të administratës publike.

13. Gjykata, duke iu referuar parashtrimeve të gjykatës referuese, paraprakisht, konstaton se mungojnë argumentet mbi kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë dy organe të administratës publike për të vlerësuar ekzistencën e varësisë hierarkike midis tyre. Po ashtu, në kërkesë nuk evidentohen argumente në lidhje me faktin se në çfarë mënyre dhe në çfarë mase kjo varësi hierarkike midis DAT dhe DRT ndikon në cenimin e të drejtës së subjektit tatimpagues për t'iu

drejtuar gjykatës për rivendosjen e të drejtave të pretenduara si të cenuara.

14. Gjykata konstaton se Kodi i Procedurave Administrative (në vijim "KPA") parashikon detyrimin që ka administrata publike që në ushtrimin e veprimtarisë së saj të zbatojë krahas parimit të ligjshmërisë (neni 9) edhe parimet e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave kushtetuese e ligjore të personave privatë (neni 10), trajtimin e tyre në respekt të parimit të barazisë (neni 11), me drejtësi e paanësi (neni 12), me përgjegjshmëri (neni 14), efikasitet dhe deburokratizim (neni 15), etj. Për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtat kushtetuese e ligjore të personave privatë, veprimtaria e administratës publike, i nënshtrohet dy formave të kontrollit: kontrollit të brendshëm administrativ dhe kontrollit gjyqësor. Sipas KPA-së, çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit për nxjerrjen e tij (neni 137/1). Në kuptim të këtij Kodi, statusin e palës së interesuar e gëzon çdo person fizik, juridik ose autoritet shtetëror, të drejtat ose kompetencat e ligjshme të të cilit, qofshin këto individuale ose të përbashkëta, kanë të ngjarë të preken gjatë procedurës administrative (neni 4). Në parim, palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë ezauruar rekursin administrativ (neni 137/3).

15. Nisur nga karakteristikat e çështjes konkrete, Gjykata vëren se objektivi i kontrollit tatimor është sigurimi i plotësisht të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesve në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, nëpërmjet zbulimit dhe parandalimit të shmangieve tatimore dhe evazionit fiskal. Kontrollat kryhen nga administrata tatimore qendrore dhe urdhërohen nga drejtori i drejtorisë rajonale të tatimeve apo drejtuesit e njësisë të ngjashme me të. Zgjedhja e tatimpaguesve, që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të kryer nga administrata tatimore, për të identifikuar tatimpaguesin, i cili ka më shumë rrezik për ta shkëlur legjislacionin tatimor. Procedurat për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore miratohen nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve (neni 80).

16. Në përmbushjen e objektivave të mësipërm kuadri ligjor ka bërë të mundur ngritjen dhe funksionimin e administratës tatimore të organizuar në nivel qendror dhe vendor. Administrata tatimore qendrore, si një institucion qendror në varësi të Ministrisë të Financave, përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj, kurse administrata tatimore vendore, përfshin zyrat tatimore, nën autoritetin e qeverisjes vendore (neni 13). Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori, ku përfshihet edhe Drejtoria e Apelit Tatimor, e parashikuar si strukturë e veçantë, e pavarur

në vendimmarrje, Drejtori i së cilës emërohet nga Ministri i Financave (neni 18).

17. Gjykata konstaton se ligji nr. 9920/2008 parashikon të drejtën e çdo tatimpaguesi që të paraqesë ankim kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me të (neni 106/1). Në funksion të ushtrimit efektiv të kësaj të drejte, Drejtoria e Apelit Tatimor është pajisur nga ligji me kompetencën për shqyrtimin e ankimit tatimor dhe marrjen e vendimit në bazë të provave dhe të argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi dhe administrata tatimore. Në përfundim të procedimit administrativ, DAT-i ka të drejtë të vendosë: a) lënien në fuqi të aktit objekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit; b) shfuqizimin/revokimin e aktit, objekt ankimi; c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin (neni 108, pikat 1-3).

18. Përveç sa më sipër, neni 109 i ligjit parashikon edhe të drejtën e kundërshtimit në gjykatë të vendimit të DAT-it si nga ana e tatimpaguesit (pika 2), ashtu edhe nga administrata tatimore (pika 3), e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi. Afati i parashikuar për të dy subjektet është i njëjtë, brenda 30 ditëve kalendrike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pajisja e DAT-it me kompetencën për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së DRT-së në raste individuale është shprehje e kontrollit të brendshëm të cilit i nënshtrohet veprimtaria e DRT-së dhe aktet që ajo nxjerr si shprehje e vullnetit të pushtetit që kësaj të fundit i është besuar nga ligji.

19. Në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera (shih vendimet nr. 7, datë 27.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

20. E drejta e ankimit gjyqësor të vendimeve të organeve të administratës publike duhet konsideruar si një e drejtë themelore autonome dhe si element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës. E

drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton mundësinë e individit për të kundërshtuar gjyqësisht një akt si dhe ekzistencën e një organi të caktuar me ligj, të pavarur dhe të paanshëm, për shqyrtimin e ankimit. Pra, në vetvete ky nen sanksionon jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjithashtu, e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, e parë nga këndvështrimi i nenit 42/2 të Kushtetutës, i cili siguron zbatimin efektiv të një procesi të rregullt ligjor, ka për qëllim t'u garantojë palëve në proces të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'i vendosur ato në çdo rast në pozita të barabarta para gjykatës (shih vendimet nr. 15, datë 17.4.2003; nr. 9, datë 2.4.2003; nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Duke iu rikthyer çështjes objekt gjykimi, Gjykata konstaton se DRT-ja, duke pretenduar se vendimi i DAT është "*i pambështetur në ligj dhe në prova dhe kundërshton për arsytet që kanë të bëjnë me uljen e gjendjes kreditore*", e ka kundërshtuar atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, duke interpretuar përmbajtjen e nenit 109, pika 3 e ka legjitimuar palën paditëse në ngritjen e padisë, si një e drejtë që i paditësit i buron nga ligji. Për sa i përket thelbit të konfliktit, gjykata, pasi ka marrë në analizë kuptimin e nenit 33 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për TVSH" i ndryshuar, ka arritur në përfundimin se tatimpaguesi është kredituar gabim, duke vendosur, për rrjedhojë, "pranimin e kërkesë padisë të DRT dhe anulimin e pjeshëm të vendimit të DAT". Në këtë proces gjyqësor subjekti tatimpagues ka marrë pjesë me cilësinë e personit të tretë. Kundër vendimit të mësipërm, subjekti tatimpagues ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila duke vënë në dyshim legjitimitimin e DRT-së për të vënë në lëvizje procesin gjyqësor, ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese.

22. Gjykata vlerëson se nëse ligjvënësi do të kishte pasur qëllim vendosjen e DRT-së në varësi hierarkike të DAT-it do të kishte parashikuar elementet kryesore që e drejta administrative ka evidentuar për varësinë hierarkike administrative, siç është elementi i llogaridhënies, pra detyrimin e DRT-së të japë informacion dhe të shpjegojë qëndrimin e saj në veprimtarinë e kontrollit. Edhe për sa i përket raportit midis Drejtorisë së Apelit dhe Ministrit të Financave, ky i fundit edhe pse ka kompetencë të emërojë Drejtorin e DAT, nuk ka forcë vendimmarrëse për të shfuqizuar vendimet e DAT. Në mungesë të këtyre karakteristikave, Gjykata vlerëson se pajisja e DAT nga ligji, midis të tjerash, edhe me kompetencën e shfuqizimit/revokimit të akteve të DRT, nuk është shprehje e varësisë hierarkike midis këtyre organeve, por përfaqëson mekanizmin kontrollues të ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese të DRT-së në pajtueshmëri me ligjin.

23. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të nenit 118 të Kushtetutës

24. Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu se parashikimi ligjor vjen në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve normative, në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës, pasi nuk respekton parimet e sanksionuara në ligje të përforcuara si Kodi i Procedurës Civile (nenet 324-325), ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Kodi i Procedurave Administrative (nenet 10, 18, 121, 124).

25. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës, gjyqtarët i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve, duke respektuar hierarkinë e burimeve të së drejtës. Bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, marrëdhëniet midis normave juridike bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlershmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata, ashtu sikundër është shprehur edhe më parë gjatë jurisprudencës së saj, vlerëson se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme apo ligjeve dhe kodeve. Në juridiksionin e Gjykatës hyjnë papajtueshmëria e ligjeve apo kodeve me Kushtetutën. Mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata rikonfirmon qëndrimin e saj se një çështje nuk hyn në sferën e kontrollit kushtetues nëse kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat si të tilla hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatës referuese.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se neni 109/3 i ligjit nr. 9920/2008 nuk cenon të drejtën e aksesit në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nuk bie ndesh me standardet e përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës. Për pasojë, kërkesa e gjykatës referuese është e pabazuar dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha,

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Gani Dizdari, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit Tiranë lidhur me antikushtetushmërinë e nenit 109/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Shumica, duke iu referuar parashtrimeve të gjykatës referuese, paraprakisht, ka konstatuar se mungojnë argumentet mbi kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë dy organe të administratës publike për të vlerësuar ekzistencën e varësisë hierarkike midis tyre (*shih paragrafin 13 të vendimit*).

2. Shumica, gjithashtu, ka arritur në përfundimin se Drejtoria Rajonale Tatimore dhe Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk qëndrojnë në raport varësie hierarkike ndërmjet tyre, pasi ligjvënësi nuk ka parashikuar elementet kryesore që e drejta administrative ka evidentuar për varësinë hierarkike administrative, siç është elementi i llogaridhënies, pra detyrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore të japë informacion dhe të shpjegojë qëndrimin e saj në veprimtarinë e kontrollit. Në mungesë të këtyre karakteristikave, sipas shumicës, pajisja e Drejtorisë së Apelit Tatimor nga ligji, midis të tjerash, edhe me kompetencën e shfuqizimit/revokimit të akteve të Drejtorisë Rajonale Tatimore, nuk është shprehje e varësisë hierarkike midis këtyre organeve, por përfaqëson mekanizmin kontrollues të ushtrimit të veprimtarisë të Drejtorisë Rajonale Tatimore në pajtueshmëri me ligjin (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

3. Përpjekjet e shumicës për të argumentuar arsyet e rrëzimit të kërkesës, i gjej të sforcuara dhe kontradiktore. Ndryshe nga shumica mendoj se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e saj.

4. Pretendimet e gjykatës referuese, në thelb, kanë të bëjnë me raportin që ekziston ndërmjet dy organeve, Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe Drejtorisë së Apelit

Tatimor. Shumica, edhe pse evidenton një prej elementëve të raportit të hierarkisë administrative, kur vlerëson se pajisja e kësaj të fundit me kompetencën për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimmarrjes së Drejtorisë Rajonale Tatimore është shprehje e kontrollit të brendshëm të cilit i nënshtrohet veprimtaria e Drejtorisë Rajonale dhe aktet që ajo nxjerr, si shprehje e vullnetit të pushtetit që kësaj të fundit i është besuar nga ligji (*shih paragrafin 18 të vendimit*), nuk pranon se ndërmjet këtyre organeve ekziston një raport hierarkie.

5. Nga një shqyrtim i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, vërehet se ligjvënësi i ka përfshirë këto dy organe brenda të njëjtës strukturë të administratës tatimore, asaj të administratës tatimore qendrore (shih nenet 13, 14 dhe 18 të ligjit). Më konkretisht, Administrata tatimore qendrore, si një institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave, përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale dhe njësitë e tjera të saj (neni 13/1/a). Administrata tatimore qendrore është e organizuar në drejtori, ku përfshihet edhe Drejtoria e Apelimit Tatimor, e parashikuar si strukturë e veçantë, e pavarur në vendimmarrje, Drejtori i së cilës emërohet nga Ministri i Financave (neni 18).

6. Organ drejtues i administratës tatimore qendrore është Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave (neni 17). Pra si drejtoria rajonale, si Drejtoria e Apelimit Tatimor kanë të njëjtin organ epror. Është ky organ që zbaton, sipas ligjit, edhe procedurën disiplinore. Kështu neni 22 i ligjit de quo parashikon se Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve shqyrtton rastet e shkeljeve, të evidentuara nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë të administratës tatimore qendrore dhe miraton masat disiplinore, në cilësinë e eprorit direkt.

7. Për sa i përket Ministrit të Financave, ai jo vetëm emëron Drejtorin e Drejtorisë së Apeliteve Tatimore dhe propozon Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, sikurse u përmend më lart, por ligji i atribuon një sërë kompetencash edhe në lidhje me miratimin e procedurave për kryerjen e kontrolleve tatimore dhe llojet e kontrolleve tatimore (neni 80).

8. Gjithashtu, Drejtoria e Apelimit Tatimor është pajisur nga ligji me kompetencën e kontrollit edhe të akteve të drejtorive rajonale nëpërmjet shqyrtimit të ankimit tatimor të tatimpaguesit. Në përfundim të procedimit administrativ, ajo ka të drejtë të vendosë: a) lënien në fuqi të aktit objekt ankimi dhe rrëzimin e ankimit; b) shfuqizimin/revokimin e aktit, objekt ankimi; c) ndryshimin e aktit, objekt ankimi, duke e pranuar pjesërisht ankimin (neni 108, pikat 1-3).

9. Nisur nga këto të dhëna çmoj se është *non sens* që Drejtoria Rajonale Tatimore të konsiderohet jashtë një

raporti varësie hierarkike nga Drejtoria e Apelimit Tatimor. Këto dy organe nuk janë të pajisur me personalitet juridik të veçantë apo nuk janë konsideruar nga ligjvënësi si ente autonome, secili me kompetencat e saj, por gjenden të përfshira brenda administratës tatimore qendrore, e cila është në varësi të Ministrit të Financave. Ky i fundit emëron Drejtorin e Drejtorisë së Apeliteve Tatimor. Pavarësisht mungesës së specifikimeve ligjore mbi të drejtën e Ministrit të Financave për t'i kërkuar llogari Drejtorisë së Apeliteve Tatimor, kjo e drejtë nënkuptohet nga kompetencat e lartpërmendura që ligji në fjalë i ka dhënë Ministrit të Financave. Llogaridhënia është një tjetër element që evidenton ekzistencën e varësisë hierarkike ndërmjet këtyre organeve si dhe varësinë e tyre hierarkike nga Ministri i Financave.

10. Për më tepër aktet e drejtorisë rajonale, sikurse u përmend, janë objekt kontrolli nga Drejtoria e Apeliteve Tatimor. Sipas mendimit tim, në bazë të kësaj kompetence, akti i Drejtorisë së Apeliteve Tatimor zëvendëson atë të drejtorisë rajonale. Pra, ky pushtet i garanton Drejtorisë së Apeliteve Tatimor të anulojë apo reformojë vendimet e Drejtorisë Rajonale Tatimore duke i dhënë vendimeve të saj një forcë detyruese.

11. Kriteret e lartpërmendura të llogaridhënies, pushtetit të reformimit të vendimeve, apo qoftë edhe të marrjes së masave disiplinore (në kompetencë të organit epror Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve) mendoj se përmbushin elementët që karakterizojnë marrëdhënien hierarkike midis organeve në fjalë. Për më tepër vlerësoj se ato nuk lejojnë që Drejtoria e Apeliteve Tatimor të konsiderohet si një strukturë e pavarur, sikurse argumenton shumica.

12. Në këto kushte, është i papranueshëm, nga pikëpamja kushtetuese, ankimi administrativ gjyqësor i një organi të administratës (drejtorisë rajonale) ndaj vendimeve të një organi të administratës në shkallë hierarkie më të lartë, pasi kundërshtimi në gjykatë i tyre, në rastin konkret, të akteve të Drejtorisë së Apeliteve Tatimor nga ana e drejtorisë rajonale, do të transformohej në një mjet për të zgjidhur konfliktet ndërmjet organeve të administratës tatimore, duke cenuar në mënyrë të njëanshme interesat e të tretëve (subjekteve tatimpaguese). Konfliktet midis organeve administrative në shkallë hierarkike mund dhe duhet të zgjidhen nga organi që qëndron më lart në piramidën hierarkike, në rastin konkret nga Ministri i Financave dhe jo nga gjykata.

13. Në çështje të ngjashme, Këshilli i Shtetit i Republikës së Italisë⁴ ka vlerësuar se përjashtohet nga e

⁴ Këshilli i Shtetit i Republikës së Italisë është një organ kushtetues që ka një funksion të dyfishtë, administrativ dhe gjyqësor. Për sa i përket funksionit gjyqësor është gjykatë e shkallës së dytë e sistemit gjyqësor administrativ (gjykatë apeli ndaj vendimeve të

drejta për të kundërshtuar në rrugë gjyqësore vendimin e pranimit të ankimit të bërë në rrugë administrative, organi që ka nxjerrë aktin administrativ, për shkak të forcës detyruese që ka vendimi i pranimit të ankimit administrativ ndaj këtij organi⁵.

14. Në të kundërt, referuar linjës së ndjekur nga shumica, çdo lloj gjykimi i bazuar në parashikimin ligjor të nenit 109/3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, do ta bënte procesin e parregullt në aspektin kushtetues sepse duke cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të individit do të cenonte thelbin e së drejtës në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 42 të Kushtetutës.

Anëtar: Vladimir Kristo

VENDIM
Nr. 40, datë 7.7.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “ |
| Vitore Tusha | anëtare e “ “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtare e “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i “ “ |
| Fatos Lulo | anëtar i “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i “ “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 6.5.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen me nr. 16 Akti, që i përket:

KËRKUES: Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Petrit Çomo, z. Gerd Hoxha dhe z. Luan Hasneziri.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Alban Brati, me autorizim,

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga z. Sokol Pasho, me autorizim., Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, të shprehjeve “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, të nenit 3, dhe “të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm” të shkronjës b/ii, të pikës 2,

të nenit 3, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 151/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”;

Pezullimi i zbatimit të këtyre dispozitave, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 131, shkronja “a”, 134/1, shkronja “f”, 138 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesit, Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që kërkuan rrezimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 151, datë 30.5.2013 (*në vijim ligji nr. 151/2013*), ka bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8588/2000, *i ndryshuar*). Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 1.10.2013. Sipas nenit 3, të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar: “1. Gjyqtar në Gjykatën e Lartë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte: a) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë; b) të ketë punuar si: i) gjyqtar për jo më pak se 13 vjet, nga të cilat të paktën 5 vite pune si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit; (...); 2. Kandidatët, që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, zgjidhen gjyqtarë në Gjykatën e Lartë: a) në bazë të këtyre kritereve objektive: (...) b) në bazë të vlerësimit të kritereve shtesë të mëposhtme: (...) ii) të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm; (...)”.

II

2. **Kërkuesi**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se:

2.1 Shprehja “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, e nenit 3, pika 1, shkronja “b/i”, të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, cenon:

a) Nenin 138 të Kushtetutës dhe garancitë kushtetuese që burojnë nga ky nen të cilat lidhen me respektimin e statusit të gjyqtarit;

Gjykatave Administrative Rajonale) pasi ka si detyrë mbrojtjen ndaj akteve të administratës publike.

⁵ Këshilli i Shtetit i Republikës së Italisë, mendimi nr. 349, datë 25.01.1978.

b) Parimin e sigurisë juridike në këndvështrim të të drejtave të fituara me ligjin e mëparshëm (qenia gjyqtar jo më pak se 10 vjet) si dhe në lidhje me karrierën e cila, si element i statusit të gjyqtarit, garantohet nga neni 138 i Kushtetutës;

c) Parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, duke krijuar pabarazi ndërmjet gjyqtarëve me vjetërsi, kualifikim, nivel profesional e integritet moral të njëjtë;

ç) Normat ndërkombëtare që rregullojnë statusin e gjyqtarit si Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit dhe Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit.

2.2 Shprehja “ii) të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”, të nenit 3, pika 2, shkronja “b/ii” të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, cenon:

a) Pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor, të parashikuar nga neni 145/1 i Kushtetutës, pasi pushteti gjyqësor nuk ka hierarki dhe gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve;

b) Parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, për shkak se ky kriter nuk është vendosur për shkaqe objektive dhe të përligjura;

c) Parimin e proporcionalitetit në kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuar nga neni 17/1 i Kushtetutës për arsye se vendos një kriter kufizues jo proporcional dhe pa pasur një interes publik të ligjshëm;

ç) Normat ndërkombëtare që rregullojnë statusin e gjyqtarit si Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit dhe Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit.

3. Përveç shfuqizimit të shprehjeve të mësipërme, kërkuesi ka kërkuar edhe pezullimin e zbatimit të dispozitave që përmbajnë këto shprehje për shkak se, sipas tij, zbatimi i këtyre dispozitave antikushtetuese do të sillte një dëm të pariparueshëm për gjyqtarët të cilët aspirojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë.

4. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka prapësuar si vijon:

4.1 Për shprehjen “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, e nenit 3, pika 1, shkronja “b/i”, të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, ai ka parashtruar argumentet e mëposhtme:

a) Ky parashikim ligjor nuk cenon në thelb parimet kushtetuese të sanksionuara në nenin 138 të Kushtetutës. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave, që sigurojnë këto parime, nuk është sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete por lidhet me mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor.

b) Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak të kriterit të vendosur nga

parashikimi ligjor i mësipërm, nuk është i bazuar pasi ky parim përfshin dhe mbulon liritë dhe të drejtat themelore të individit me karakter civil dhe jo ato me karakter publik. Sistemin e garancive gjyqtarët nuk e gëzojnë si individë por për shkak të funksionit që kryejnë.

c) Kjo dispozitë nuk cenon parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë para ligjit pasi gjyqtarët e shkallëve të ndryshme gëzojnë të njëjtat garanci në ushtrimin e funksionit të tyre, ndërsa në këndvështrim të promovimit dhe karrierës nuk ndodhen në kushte objektivisht të barabarta, ndaj, për pasojë, trajtimi i tyre në këtë aspekt nuk mund të jetë i njëjtë.

ç) Duke e vlerësuar këtë dispozitë së bashku me kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi, rezulton se ajo i përmbush kërkesat e nenit 13 “Parimeve themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit” dhe nenit 41 të “Kartës Evropiane mbi statusin e gjyqtarit”.

4.2 Për shprehjen “ii) të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”, të nenit 3, pika 2, shkronja “b/ii” të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, ai ka paraqitur këto argumente:

a) Ky parashikim ligjor nuk cenon pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor të parashikuar në nenin 145 të Kushtetutës pasi edhe pse, në kuptimin hierarkik, nuk ka një detyrim varësie funksionale të gjykatës më të ulët ndaj asaj më të lartë, vendimet e gjykatave më të ulëta kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë.

b) Pretendimi i kërkuesit në lidhje me cenimin e parimeve të mosdiskriminimit dhe barazisë para ligjit nuk është i bazuar për shkak se trajtimi i diferencuar në këtë rast është proporcional dhe është bërë për arsye objektive. Në funksion të mbrojtjes së interesit publik drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por gjithashtu edhe të shihet që bëhet.

c) Kufizimi që përmban kjo dispozitë përmbush të gjitha kriteret e sanksionuara në nenin 17 të Kushtetutës pasi është bërë me ligj, për një interes publik, i diktuar nga gjendja aktuale dhe në përpjesëtim me të. Rrjedhimisht, pretendimi i kërkuesit për cenimin e nenit 17 të Kushtetutës nuk qëndron.

5. **Subjekti i interesuar**, Këshilli i Ministrave (KM), parashtroi se sipas relacionit shoqërues të projektligjit rezulton se ndryshimet kanë pasur si objektiva kryesore përcaktimin e procedurave të qarta e rigorozë për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, me qëllim rritjen e transparencës në emërimin tyre dhe rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të kësaj gjykate. Sipas përfaqësuesit të subjektit të interesuar, KM, Gjykata e Lartë është maja e piramidës gjyqësore ndaj anëtarët e saj që vijnë nga radhët e gjyqtarëve duhet të kenë një karrierë të konsoliduar dhe arritja në këtë gjykatë duhet të kryhet në mënyrë graduale.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të dispozitave ligjore, objekt kërkesë

6. Kërkuesi ka kërkuar pezullimin e zbatimit të dispozitave ligjore, objekt kërkesë, duke argumentuar se zbatimi i këtyre dispozitave do të sillte një dëm të pariparueshëm për gjyqtarët të cilët synojnë të ndjekin procedurën për t'u emëruar si anëtarë të Gjykatës së Lartë.

7. Gjykata Kushtetuese mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi, të paraqitur nga kërkuesi dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Për rrjedhojë, Gjykata, në datën 02.04.2014, ka vendosur rrezimin e kësaj kërkesë, si të pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciues, që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, në cilësinë e "organizatave të tjera", janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'u drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta (*shih vendimet nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Shoqatat duhet të provojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin janë krijuar apo veprimtarisë që ato kryejnë dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, që kërkojnë të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për

të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesi legjitimohet racione personae në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, pika 1, shkronja "f" i Kushtetutës dhe neni 49, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2171, datë 4.2.2008. Në Statutin e Shoqatës, neni 1, parashikohet: "*Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare*". Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të juridiksionit të zakonshëm. Neni 8 i Statutit, parashikon se "*...duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ...; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv*". Në këto kushte, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, pasi është krijuar si shoqatë dhe gëzon personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

12. Kërkuesi ka iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt dhe, sipas kërkesave të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, për t'u legjitimuar ka detyrimin të provojë lidhjen e domosdoshme që ekziston ndërmjet veprimtarisë ligjore që ai kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Sipas Statutit, rezulton se "*misioni i Unionit ka në fokus të veprimtarisë së tij mbrojtjen e interesave profesionale dhe materiale të gjyqtarëve, në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor*". Kërkuesi ka kërkuar papajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave, objekt kërkesë, duke pretenduar se ato cenojnë interesat e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë si dhe karrierën e gjyqtarëve, si element esencial i statusit që ata gëzojnë. Duke qenë se qëllimi i kërkuesit është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të gjyqtarëve, është e drejta e tij që në çdo rast kur konstaton se një normë cenon interesat e tyre, në tërësi ose në veçanti, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për

shfuqizimin e normës konkrete (*shih vendimin nr. 11, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga sa më sipër, bazuar në statutin, aktin e themelimit dhe natyrën e veprimtarisë së shoqatës, provohet lidhja e drejtpërdrejtë midis veprimtarisë ligjore për të cilën ajo është krijuar dhe çështjes kushtetuese të pretenduar prej saj. Në këto rrethana kërkuksi legjitimohet për vënien në lëvizje të Gjykatës në funksion të kontrollit kushtetues të dispozitave ligjore, objekt shqyrtimi. Edhe për sa i përket legjitimitimit racione temporis, Gjykata vëren se kërkuksi e ka paraqitur kërkesën në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

C. *Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të shprehjes “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, neni 3 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar.*

14. Kërkuksi ka pretenduar se kjo dispozitë cenon: 1) nenin 138 të Kushtetutës dhe garancitë kushtetuese që lidhen me statusin e gjyqtarit (palëvizshmëria, paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera), të cilat kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur; duke vendosur si kusht “*sine qua non*” të qenit gjyqtar për 5 vjet në gjykatën e apelit, kjo dispozitë u mohon gjyqtarëve, të cilët i plotësojnë kushtet e tjera por nuk janë pjesë e trupave gjykues në gjykatat e apelit, për shkaqe objektive, të drejtën për t’u përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë; 2) parimin e sigurisë juridike për arsye se në ligjin e mëparshëm ishte parashikuar si kriter të qenit gjyqtar jo më pak se 10 vjet, çka përbën një të drejtë të fituar edhe të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe një përfitim që sipas nenit 138 të Kushtetutës nuk mund të ulët; 3) parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, duke krijuar pabarazi ndërmjet gjyqtarëve me vjetërsi, kualifikim, nivel profesional e integritet moral të njëjtë dhe duke parashikuar një kriter diskriminues, përjashtues dhe kufizues që nuk bazohet mbi meritokracinë dhe integritetin profesional të gjyqtarit; 4) normat ndërkombëtare që rregullojnë statusin e gjyqtarit, konkretisht pikën 13 të “Parimeve themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit” dhe pikën 1 të nenit 4 të “Kartës Evropiane për statusin e gjyqtarit”.

15. Neni 138 i Kushtetutës parashikon se: “Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen”. Kjo normë e Kushtetutës është përfshirë në Pjesën e IX me titull “Gjykatat”, ku parashikohen parimet mbi të cilat organizohet dhe funksionon pushteti gjyqësor. Një nga parimet më të rëndësishme të

sanksionuara në disa norma kushtetuese është edhe pavarësia e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 31, datë 2.12.2009 dhe nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka theksuar se statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku, krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 26, datë 24.7.2009; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 11, datë 27.5.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sistemi i garancive që gëzojnë gjyqtarët parashikohet edhe në dokumente ndërkombëtare. Kështu, Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit, në paragrafin 1/1, shprehet se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elementë këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Gjithashtu, “Parimet Bazë mbi Pavarësinë e Gjyqësorit” (miratuar me Rezolutat 40/32, datë 29 nëntor 1985 dhe 40/146, datë 13 dhjetor 1985 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së), në paragrafin 11, sanksionojnë se mandati i gjyqtarëve, pavarësia e tyre, siguria, paga e përshtatshme, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e daljes në pension duhet të sigurohen nga ligji në mënyrë të përshtatshme (*shih vendimin nr. 31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata, në çështjen në shqyrtim, vlerëson të shprehet fillimisht nëse karriera e gjyqtarëve përfshihet në rrethin e përfitimeve të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës, siç pretendon kërkuksi.

19. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementë përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë

nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre (*shih vendimin nr. 31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Ligjvënësi i ka përfshirë kriteret e rekrutimit dhe të karrierës së gjyqtarëve në ligjin organik për pushtetin gjyqësor (shih kreun III të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar). Ky ligj parashikon kushtet për t'u emëruar gjyqtar, procedurën dhe kriteret e emërimit të gjyqtarit në shkallët përkatëse si dhe mënyrën e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin e karrierës.

21. Edhe Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit e përfshin karrierën në garancitë që gëzon gjyqtari së bashku me garanci të tjera si: paga, pensioni, përzgjedhja, rekrutimi dhe emërimi nga një entitet i pavarur.

22. Bazuar në analizën e mësipërme, Gjykata vlerëson se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë.

23. Parimi i sigurisë juridike mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta e karrierës, si pjesë përbërëse e statusit të gjyqtarit dhe një nga përfitimet e tjera që gjyqtarët gëzojnë, për shkak të funksionit. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Qëllimi i parimit të sigurisë juridike është të sigurojë besimin e personave të shteti e ligji dhe, vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë duhet të gëzojnë një besim të tillë. Ligjvënësi ka detyrimin të rregullojë, në mënyrë më të hollësishme, të drejtat dhe garancitë e parashikuara në Kushtetutë. Në kuadrin e këtij rregullimi ai mund të vendosë dhe kufizime, por këto kufizime duhet të bëhen vetëm për një interes publik, për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve me mënyra dhe forma që të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka

diktuar ndryshimin dhe pa prekur thelbin e të drejtës dhe garancisë (*shih vendimet nr. 11, datë 6.3.2014; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 11, datë 4.4.2007; nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 26, datë 2.11.2005; nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në rastin konkret, dispozita ligjore, objekt shqyrtimi, duke e lidhur emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, me kriterin e ushtrimit të funksionit gjyqësor në apel për një kohë të caktuar (5 vjet) ka vendosur një kufizim të karrierës për gjyqtarët që nuk e përmbushin këtë kriter, kufizim që është pranuar edhe nga vetë përfaqësuesi i subjektit të interesuar, KM, gjatë seancës gjyqësore. Në këto kushte, Gjykata vlerëson nëse ky kufizim është vendosur nga ligjvënësi në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet.

25. Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyeshme publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë/garanci kushtetuese. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit të çdo rasti konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë (*shih vendimet nr. 2, datë 18.2.2013 dhe nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen në shqyrtim, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, KM, theksoi se, sipas relacionit shoqëruar të projektligjit: “ndryshimet kanë pasur si objektiva kryesorë përcaktimin e procedurave të qarta e rigorozë për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, me qëllim rritjen e transparencës në emërimin e tyre dhe rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të kësaj gjykate (...) duke qenë Gjykata e Lartë maja e piramidës gjyqësore është e preferueshme që arritja të kryhet në mënyrë graduale duke kaluar nëpërmjet gjykatës së apelit (...) Secili nga gjykimet, ai i shkallës së parë dhe ai në apel e pajisin gjyqtarin me një eksperiencë unike që mund të përftohet vetëm duke shërbyer efektivisht në secilën shkallë”. Gjykata, duke e vlerësuar rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë nën dritën e interesit publik, e konsideron atë si shkak të arsyeshëm për ndërhyrjen konkrete të ligjvënësit.

27. Lidhur me respektimin e parimit të proporcionalitetit, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte si, balancën mes të drejtës/garancisë së kufizuar dhe

interesi publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën/garancinë e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën. Baraspeshimi i ndërhyrjes, me gjendjen që e ka diktuar ndërhyrjen, imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 12, datë 14.4.2010 dhe nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këndvështrim të këtyre kriterëve kushtetuese, Gjykata vlerëson nëse në çështjen në shqyrtim, kufizimi i karrierës së gjyqtarit është proporcional me rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, çka është dhe synimi që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi. E drejta e karrierës së bashku me garancitë e tjera që parashikon neni 138 i Kushtetutës janë pjesë përbërëse të statusit të gjyqtarit dhe si të tilla i shërbejnë pavarësisë së gjyqësorit. Sipas jurisprudencës kushtetuese kjo pavarësi, ndër të tjera, nënkupton për gjyqtarët emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor (*shih vendimin nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Karta Evropiane për statusin e gjyqtarit në parimet e përgjithshme evidenton se statusi i gjyqtarëve ka si qëllim garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë, të cilat, sipas relacionit shoqërues të Kartës, duhet të garantohen edhe në sferën e karrierës. Nëse nuk bazohet në vjetërsi, sistemi i promovimit është i bazuar ekskluzivisht në cilësitë dhe meritat që konstatohen gjatë ushtrimit të detyrës, nëpërmjet vlerësimeve objektive të organit përkatës⁶. Për këto arsye Karta përcakton si kriterë promovimi vetëm cilësitë dhe meritat në ushtrimin e detyrës, të identifikueshme përmes vlerësimeve objektive. Rekomandimi Nr. R (94) 12 i Këshillit të Evropës, të cilit i referohet Karta Evropiane e statusit të gjyqtarit, tregon një preferencë shumë të qartë për një sistem promovimi të bazuar në merita: "*Të gjitha vendimet lidhur me karrierën profesionale të gjyqtarëve duhet të bazohen në kriterë objektive dhe zgjedhja dhe karriera e gjyqtarëve duhet të bazohet në meritë, duke pasur parasysh kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin*". Neni 13 i Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e gjyqësorit shprehet se "*karriera e gjyqtarëve, aty ku ekziston një sistem i tillë, duhet të bazohet në faktorë objektivë, veçanërisht në aftësitë, integritetin dhe eksperiencën*". Po kështu edhe neni 9 i Kartës Universale të Gjyqtarëve parashikon se "përzgjedhja dhe emërimi i çdo gjyqtari

duhet të bëhet sipas kriterëve objektive dhe transparente bazuar në kualifikimin e përshtatshëm profesional". Nisur nga jurisprudenca kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare të sipërcituara, Gjykata vlerëson se karriera është një element mjaft i rëndësishëm i statusit të gjyqtarit dhe vetëm një sistem karriere i bazuar në kriterë objektive garanton ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur dhe të paanshme nga ana e gjyqtarëve.

29. Interesi publik që ka diktuar kufizimin e karrierës në rastin konkret është rritja e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Nëpërmjet vendosjes së kushtit të punës 5 vjeçare si gjyqtar apeli për t'u emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë, ligjvënësi ka synuar pajisjen e gjyqtarit me një eksperiencë unike që, sipas tij, arrihet vetëm duke shërbyer efektivisht në gjykatën e apelit. Megjithatë edhe pse ligjvënësi, për të justifikuar ndërhyrjen, e ka lidhur ngushtë rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë me eksperiencën gjyqësore efektive në gjykatën e apelit, Gjykata konstaton se vetë ligji nr. 8588/2000, i ndryshuar, lejon emërimin si anëtarë në Gjykatën e Lartë të individëve të cilët vijnë nga jashtë sistemit gjyqësor. Sipas nenit 3, pika 1, shkronja "b/ii" të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, juristët me jo më pak se 15 vjet eksperiencë profesionale mund të zgjidhen si anëtarë të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu për shkak se dispozita konkrete e lidh emërimin në Gjykatën e Lartë me shërbimin efektiv në gjykatën e apelit duhet që, në funksion të rritjes së cilësisë, sistemi aktual i progresit në karrierë, i parë në tërësi, të garantojë, vetëm mbi kriterë objektive, promovimin e gjyqtarëve në gjykatat e apelit dhe më tej emërimin e tyre në Gjykatën e Lartë. Në kushtet kur nuk ka argumente të qarta dhe bindëse në këtë drejtim nuk mund të thuhet se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis kriterit kufizues të vendosur nga ligjvënësi dhe objektivit që ai kërkon të arrijë.

30. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen në shqyrtim, mungon lidhja e drejtpërdrejtë midis vendosjes së kriterit kufizues dhe realizimit të qëllimit të ligjvënësit Nga ky këndvështrim, pretendimi i kërkuesit se shprehja "...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit", të shkronjës b/i, të pikës 1, neni 3 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar, cenon nenin 138 të Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës, është i bazuar.

Ç) Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të shprehjes "të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm" të shkronjës b/ii, të pikës 2 të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar.

31. Kërkuesi ka pretenduar se kjo dispozitë cenon: 1) pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor, të parashikuar nga neni 145/1 i Kushtetutës, pasi pushteti

⁶ Par. 4.1 i Kartës
4008

gjyqësor nuk ka hierarki dhe gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve; 2) parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës për shkak se ky kriter nuk është vendosur për shkaqe objektive dhe të përligjura; 3) parimin e proporcionalitetit në kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuar nga neni 17/1 i Kushtetutës për arsye se vendos një kriter kufizues në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe pa pasur një interes publik të ligjshëm; 4) normat ndërkombëtare që rregullojnë statusin e gjyqtarit dhe të drejtën e tij për ngritje në detyrë pasi një kriter i tillë kufizues nuk është parashikuar në asnjë nga këto norma.

32. Në nenin 145/1 të Kushtetutës parashikohet se: *“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”*. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat, ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 5, datë 16.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në nenin 145/1 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (pavarësia nga pushtetet e tjera) ka dhe një pavarësi të brendshme (gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve).

33. Sipas nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 8588/2000, *të ndryshuar*, kandidatët që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni zgjidhen gjyqtarë në Gjykatën e Lartë në bazë të kritereve objektive dhe vlerësimit të kritereve shtesë të përcaktuara përkatësisht në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike. Kriteri i mospasjes së konfliktit të interesit apo lidhjeve nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që vendos dispozita, objekt shqyrtimi, është një kriter shtesë, i cili vlerësohet së bashku me një sërë kritereve të tjera të parashikuara nga ligjvënësi. Pavarësisht se ky është një kriter shtesë, nisur nga mënyra e formulimit të dispozitës dhe interpretimi literal i saj, Gjykata çmon se natyra e këtij kriteri është ndaluese pasi përjashton nga zgjedhja në Gjykatën e Lartë kandidatët të cilët gjenden në kushtet e konfliktit të interesit apo lidhjeve nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Sipas relacionit shoqërues të projektligjit kushtet e emërimit janë imperative dhe kandidati për anëtar i Gjykatës së Lartë duhet që domosdoshmërisht të plotësojë kushtet përzgjedhëse dhe të mos ketë asnjë nga kushtet ndaluese (fq.2). Rrjedhimisht, gjyqtarët të cilët ndodhen në situata të ndaluara nga ligji, siç është rasti konkret, nuk mund të emërohen anëtarë të Gjykatës së Lartë.

34. Gjykata thekson, siç ka vlerësuar më lart në paragrafin 22, se karriera është një nga përfitimet që

gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Dispozita konkrete, duke e lidhur zgjedhjen si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, edhe me vlerësimin e kriterit shtesë që ajo ka përcaktuar, vendos një kufizim të karrierës për gjyqtarët, të cilët gjenden në situatat ndaluese të parashikuara nga kjo dispozitë. Në vijim, Gjykata vlerëson nëse ky kufizim i karrierës është vendosur nga ligjvënësi në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në proporcion me qëllimin që kërkohet të arrihet.

35. Referuar relacionit shoqërues të projektligjit, kriteret e përcaktuara në nenin 3, ku përfshihet dhe dispozita konkrete, *“kanë qëllimin të rrisin cilësinë e trupës gjyqësore dhe rritjen e imazhit të kësaj trupe në sytë e publikut të gjerë duke krijuar bindjen se personat e përzgjedhur si anëtarë të Gjykatës së Lartë janë elementë të jashtëzakonshëm dhe me një integritet të padiskutueshëm”*. Sipas jurisprudencës kushtetuese, asnjë institucion tjetër shtetëror apo zyrtar publik, përveç gjykatave të pavarura, nuk mund ta ushtrojë funksionin e dhënies së drejtësisë. Pavarësia e gjyqësorit si një i tërë është e pandarë nga pavarësia e gjyqtarit si individ dhe e gjykatës si institucion (*shih vendimet nr. 11, datë 6.4.2010; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se krijimi i besimit të publiku për sa i përket integritetit dhe imazhit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë është një qëllim që i përgjigjet interesit publik të mirëadministrimit të drejtësisë.

36. E drejta/garancia e kufizuar nga ndërhyrja e ligjvënësit në rastin konkret është karriera e cila, si pjesë integrale e statusit të gjyqtarit, mbrohet nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha garancitë kushtetuese që përfshin ky nen si palëvizshmëria, mbrojtja e pagës si dhe *“përfitimet e tjera”* janë në funksion të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin të publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve. Gjykata, pasi ka vlerësuar të drejtën e kufizuar në raport me interesin publik, arrin në konkluzionin se kufizimi i karrierës nëpërmjet kriterit ndalues të parashikuar nga dispozita, objekt shqyrtimi, nuk është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, KM, nuk parashtrroi argumente bindëse për të mbështetur qëndrimin se ky kufizim është i domosdoshëm dhe se qëllimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera më pak kufizuese. Për pasojë, pretendimi i kërkuarit se shprehja *“...të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”* të shkronjës b/ii, të pikës 2 të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar, cenon nenin 138 të

Kushtetutës, në vlerësimin e Gjykatës, është i bazuar.

37. Në lidhje me pretendimin se shprehjet që përmbajnë dispozitat ligjore, objekt shqyrtimi, cenojnë parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, Gjykata çmon se kërkuesi nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

38. Si përfundim, nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit, për sa i përket papajtueshmërisë me nenin 138 të Kushtetutës të shprehjes “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, neni 3 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar dhe shprehjes “të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”, të shkronjës b/ii, të pikës 2 të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar, janë të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të shprehjes: “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, të nenit 3 të ligjit nr. 8588/2000, të ndryshuar dhe të shprehjes “të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”, të shkronjës b/ii, të pikës 2, të nenit 3 të ligjit 8588/2000, të ndryshuar.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtare kundër: Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur pranimin e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë për shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të shprehjeve “...nga të cilët, jo më pak se 5 vite gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit”, të shkronjës b/i, të pikës 1, të nenit 3, dhe “të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm” të shkronjës b/ii, të pikës 2,

4010

të nenit 3, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar nga neni 2 i ligjit nr. 151, datë 30.5.2013.

2. Shumica ka argumentuar se karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës (*paragrafi 22 i vendimit*). Në këtë drejtim, shumica pasi ka vlerësuar nëse kufizimet e përcaktuara në shprehjet e lartpërmendura janë vendosur nga ligjvënësi në respektim të kushteve që përcakton Kushtetuta, pra për një interes publik dhe në përpjesëtim me qëllimin që kërkohet të arrihet, ka arritur në përfundimin se nuk mund të thuhet se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis kriterit kufizues të vendosur nga ligjvënësi (jo më pak se 5 vjet gjyqtar apeli) dhe objektivit që ai kërkon të arrijë (*paragrafi 29 i vendimit*) apo se kufizimi i karrierës nëpërmjet kriterit ndalues të parashikuar nga dispozita (konflikt interesi apo lidhje nepotike), nuk është proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet nga ligjvënësi (*paragrafi 36 i vendimit*).

3. Edhe pse pajtohem me vendimin e shumicës, vlerësoj se togfjalëshi “*përfitime të tjera*” i sanksionuar në nenin 138 të Kushtetutës nuk përfshin sistemin e karrierës të gjyqtarit, por ka të bëjë me përfitime morale dhe materiale për shkak të ushtrimit të detyrës, pra të qenies gjyqtar. Sistemi i karrierës nuk është përfitim, ai konsiston në vlerësimin e meritokracisë bazuar në profesionalizmin, integritetin, kualifikimet dhe aftësinë e gjyqtarit. Për rrjedhojë, jam i mendimit se antikushtetutshmëria e kushteve dhe kriterëve të reja për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, sipas sanksionimeve të ligjit nr. 151, datë 30.5.2013, duhej trajtuar në një këndvështrim tjetër dhe më të gjerë.

4. Në këtë drejtim, neni 48 i Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata, që duhet të jenë si rregull brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të, ka parashikuar edhe një përjashtim sipas të cilit i lejohet Gjykatës të vendosë për të marrë në shqyrtim edhe akte të tjera normative që kanë lidhje me objektin e kërkesës. Në përputhje me këtë nen, në rastin konkret, mendoj se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis nenit 3 të ndryshuar të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” me objektin e këtij gjykimi.

5. Nga sa më lart, ndryshe nga shumica, vlerësoj se objekt i shqyrtimit duhet të ishte i gjithë neni 3 i ndryshuar i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte më poshtë po jap arsyet e këtij mendimi paralel.

6. Neni 3 i ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë" në formulimin e tij fillestar lidhur me kushtet për t'u emëruar gjyqtar i Gjykatës së Lartë parashikonte "Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga radhët e gjyqtarëve me vjetërsi jo më pak se 10 vjet ose nga radhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar këtë profesion jo më pak se 15 vjet". Me ligjin nr. 151, datë 30.5.2013, në këtë nen janë bërë disa ndryshime që kanë pasur si objektiva kryesore përcaktimin e procedurave të qarta e rigoroze për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, me qëllim rritjen e transparencës në emërimin e tyre dhe rritjen e cilësisë së trupës gjyqësore të kësaj gjykate⁷. Gjykata e Lartë është maja e piramidës gjyqësore ndaj anëtarët e saj që vijnë nga radhët e gjyqtarëve duhet të kenë një karrierë të konsoliduar dhe arritja në këtë gjykatë duhet të kryhet në mënyrë graduale (shih relacionin shoqërues të projektligjit).

6. Ndërsa kriteret e rekrutimit dhe të karrierës së gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit janë të

⁷ Neni 3 i lartpërmendur aktualisht ka këtë përmbajtje: "1. Gjyqtar në Gjykatën e Lartë mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte: a) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë; b) të ketë punuar si: i) gjyqtar për jo më pak se 13 vjet, nga të cilat të paktën 5 vite pune si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit; ii) jurist me jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e Presidentit, aparatit të Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, prokuror, avokat dhe personelin akademik të arsimit të lartë, profesor dhe docent ose gradën shkencore "Doktor", si dhe pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës; iii) kushtet e përcaktuara në këtë shkronjë janë plotësuese; c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) të mos ketë qenë anëtar i partive politike për 5 vjetet pararendëse nga data e kandidimit; d) të mos ketë qenë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Kandidatët, që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, zgjidhen gjyqtarë në Gjykatën e Lartë: a) në bazë të këtyre kriterëve objektive: i) vjetërsisë në profesion; ii) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës; iii) vlerësimit dhe treguesve të lartë cilësorë të punës së kandidatit, ku përfshihen vendimet gjyqësore, parashtrimet, diskutimet dhe çdo akt tjetër të përgatitur nga kandidati gjatë pjesëmarrjes në gjykim; iv) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike; v) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik; vi) masave disiplinore të mëparshme, llojit dhe numrit të tyre; b) në bazë të vlerësimit të kriterëve shtesë të mëposhtme: i) të gëzojë integritet të lartë moral, ku përfshihet, ndër të tjera, transparenca e plotë dhe e dokumentuar e të gjitha të ardhurave dhe asetëve dhe pagimi i të gjitha detyrimeve tatimore; ii) të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm; iii) përbërjen e trupës gjyqësore, në momentin e emërimit të kandidatit, duke synuar balancën ndërmjet përvojave personale të anëtarëve; iv) informacioneve zyrtare të marra nga institucione të tjera publike, përfshirë edhe informacionet konfidenciale në lidhje me kandidatët.

parashikuar në nenet¹¹⁸ dhe ¹²⁹ të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

7. Nga shqyrtimi, në mënyrë kronologjike, i këtyre ligjeve vihet re se fillimisht kriteri i zgjedhur nga ligjvënësi për t'u emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Lartë ishte ai i vjetërsisë (si për gjyqtarët ashtu edhe për juristët). Po kështu ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor për emërimin si gjyqtar apeli (apo gjyqtar i krimeve të rënda), si kriter rekrutimi përcaktonte kushtin e vjetërsisë dhe vlerësimin e meritokracisë (neni 12/2/3 i lartpërmendur). Neni 3 i ligjit nr. 151, datë 30.5.2013 vendos kriteret dhe kufizime të reja, të ndryshme nga ato ekzistuese, për promovimin në Gjykatë të Lartë.

8. Neni 13 i Parimeve Themelore të Kombeve të Bashkuara shprehet se "karriera e gjyqtarëve, aty ku ekziston një sistem i tillë, duhet të bazohet në faktorë objektivë, veçanërisht në aftësitë, integritetin dhe eksperiencën". Po kështu edhe neni 9 i Kartës Universale të Gjyqtarëve parashikon se "përzgjedhja dhe emërimi i çdo gjyqtari duhet të bëhet sipas kriterëve objektive dhe transparente bazuar në kualifikimin e përshtatshëm profesional". Duke ju referuar edhe rrethimeve të ndryshme evropiane, konstatohet se për promovimin e gjyqtarëve përdoren sisteme (modele) të ndryshme. Krahas sistemit të progresionit në karrierë, njihet ai i vjetërsisë, dhe i meritokracisë. Kështu, Italia ka tejkualuar sistemin e progresionit në karrierë, të cilin e ka zëvendësuar me sistemin e vlerësimit të profesionalizmit (çdo katër vjet). Gjithsesi nuk mungojnë edhe vendet që përdorin një sistem miks.

9. Nisur nga sa më sipër, mendoj se tendenca e ligjvënësit në përcaktimin dhe zgjedhjen e modelit përkatës të karrierës së gjyqësorit konsiston në garantimin e funksionalitetit të sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe të qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tij.

⁸ Neni 11 parashikon: "1. Gjyqtar mund të emërohet shtetasi shqiptar, që përmbush kriteret e mëposhtme: a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë me arsim të lartë juridik; c) të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës; ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; d) të ketë cilësi të larta morale dhe aftësi profesionale".

⁹ Neni 12 parashikon: "2. Gjyqtari i gjykatës për krimet e rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrencës me jetëshkrime, pasi: a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në gjykatat e shkallës së parë; b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit; ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Gjyqtari i gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrencës me jetëshkrime, pasi: a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në gjykatat e shkallës së parë; b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale; c) të jetë vlerësuar "Shumë mirë" për aftësi profesionale dy herët e fundit; ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi".

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i sigurisë juridike, përfshin, besimin tek sistemi juridik, pa marrë përparësi garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion. Shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 9, datë 26.2.2007; nr. 24, datë 12.11.2008; nr. 4, datë 12.2.2010; nr. 31, datë 18.6.2010; nr. 43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjithashtu, Gjykata, është shprehur se për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (*shih vendimet nr. 36, datë 15.10.2007, nr. 52, datë 1.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma nuk janë të papajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga sa më lart, jam i mendimit se neni 3, objekt shqyrtimi, ka shtuar kritere të reja për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, të cilat vijnë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Konkretisht, pika 1, shkronja b/i e këtij neni parashikon kriterin pengues të përkatësisë si gjyqtar apeli për 5 vjet; pika 2, shkronja b/ii përcakton kriterin objektiv që të mos ketë konflikt interesi apo lidhje nepotike me gjyqtarë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm; këtyre kritereve i nënshtrohen vetëm gjyqtarët; pika 1, shkronja b/ii përcakton institucionet ku duhet të kenë përvojën profesionale juristët; pika 2, shkronja a/v

sanksionon edhe kriterin objektiv të ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik.

14. Nga këto parashikime vlerësoj se vendosja e kritereve të reja për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë krijon paqartësi në funksionimin e sistemit të promovimit të gjyqësorit dhe krijon kontradikta si brenda ligjit ashtu edhe në raport me ligje të tjera që rregullojnë probleme të kësaj natyre brenda për brenda sistemit gjyqësor, respektivisht ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, për pushtetin gjyqësor dhe kodet e procedurës penale dhe civile. Kështu, ndonëse në ligjin për pushtetin gjyqësor ligjvënësi ka bërë përpjekje për të zbatuar sistemin e karrierës, në kuptimin juridik të fjalës, për promovimin e gjyqtarëve (neni 12/3 i lartpërmendur), një përpjekje e tillë në ligjin organik të Gjykatës së Lartë, për shkak të përzierjes së kritereve me natyrë objektive me ato të progresionit të karrierës në promovimin e gjyqtarëve, krijon paqartësi dhe konfuzion, të cilat pasjellin edhe probleme të zbatimit në praktikë të ligjit.

15. Me fjalë të tjera, neni 3 i ligjit në fjalë nuk përmirëson sistemin dhe çështjet e karrierës për gjyqësorin, por jep disa zgjidhje *non sens* që bien ndesh me kriteret e përcaktuara nga ligji i pushtetit gjyqësor (sistemin e promovimit për gjyqtarët e tjerë) dhe për më tepër krijon përplasje në plotësimin e kushteve për t'u zgjedhur si gjyqtar në Gjykatën e Lartë në raportin brenda dhe jashtë gjyqësorit, duke vendosur kufizime vetëm për gjyqtarët dhe jo për juristët.

16. Në këtë këndvështrim jam i mendimit se ligjvënësi, për arritjen e objektivit të përmirësimit të funksionimit dhe rritjes së performancës së institucionit më të rëndësishëm të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, duhet të përcaktojë fillimisht çfarë sistemi duhet të zgjidhet (progresionit në karrierë; meritokracisë etj.) dhe pastaj të përcaktojë kriteret e duhura për secilën zgjedhje. Duke shkuar më tej, shihet e nevojshme jo vetëm harmonizimi i legjislacionit për çështjet e karrierës së gjyqësorit, por, në këtë kuadër, me qëllim krijimin e një sistemi gjyqësor funksional, është i domosdoshëm rishikimi tërësor i ligjit organik për Gjykatën e Lartë dhe funksioneve të saj (kodet e procedurës penale dhe civile në pjesën që parashikojnë funksionet e Gjykatës së Lartë duhet të jenë në përputhje me nenin 141 të Kushtetutës). Praktikisht ne vazhdojmë të kemi një Gjykatë të Lartë të dyzuar, e cila funksionon ende edhe si gjykatë kasacioni.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e

çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave nuk është e sanksionuar si privilegj apo qëllim në vetvete, por ajo lidhet me mirëfunksionimin e shtetit dhe të drejtën e shtetasve për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre. Statusi ligjor i gjyqtarëve duhet të jetë në funksion të garantimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen kryesisht me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht pa pëlqimin e KLD-së dhe disiplinuarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare (*shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 26, datë 24.7.2009; nr. 5, datë 16.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur. Siguria në lidhje me pagën dhe me ushtrimin e qëndrueshëm të detyrës krijojnë kushtet e nevojshme që gjyqtarët të zbatojnë ligjin në mënyrë të drejtë e të paanshme (*shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004; nr. 16, datë 27.4.2007; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 26, datë 24.7.2009; nr. 31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Sipas jurisprudencës kushtetuese, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementët përbërës të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elementë të tjerë që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat/përfitimet, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit “përfitime të tjera” është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi, jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë në të tërësinë e të drejtave që gjyqtarët i gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre (*shih vendimin nr. 31, datë 2.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Duke qenë se karriera në sistemin gjyqësor është analizuar si një ndër përfitimet e parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës, vlerësoj që paraprakisht të ndalem në

mënyrën sesi doktrina juridike e trajton çështjen e karrierës në sistemin gjyqësor.

6. Studiuesit e së drejtës kanë evidentuar ekzistencën e dy sistemeve/modeleve përmes të cilave realizohet promovimi në sistemin gjyqësor, konkretisht “karriera” dhe “njohja”. Zbatimi në praktikë i këtyre modeleve, si për sa i përket vendeve të sistemit civil law, ashtu dhe të common law nuk është tërësisht i ndarë, në kuptimin që ekzistojnë vende ku këto dy modele zbatohen të kombinuara, duke i dhënë kështu jetë një sistemi të kombinuara ose hibrid.¹⁰

7. Në modelin e gjyqësorit të bazuar mbi karrierën (*career judiciary*), i cili është karakteristikë veçanërisht e vendeve të civil law, gjyqtarët bëhen pjesë e sistemit gjyqësor në moshë të re, promovohen në nivele të tjera të sistemit gjyqësor duke kulmuar karrierën e tyre në Gjykatën e Lartë. Ky model promovimi njeh edhe transferimin e gjyqtarëve në nivele paralele, mandati i tyre nuk lidhet me ndonjë pozicion konkret, por ka të bëjë me të gjithë karrierën. Mekanizmat e emërimit të gjyqtarëve që përdoren në këtë model janë të izoluara nga konsideratat politike, pasi ato konsistojnë në këshilla gjyqësore të pushtetshëm, të cilët ndërmjetësojnë midis politikës dhe menaxhimit gjyqësor, duke u shndërruar në mjete potenciale për të siguruar një gjyqësor të përgjegjshëm dhe të pavarur.¹¹

8. Kurse në modelin e njohjes (*recognition judiciary*), i cili gjen zbatim në SHBA dhe vendet e common law, gjyqtarët emërohen në fazat e mëvonshme të jetës së tyre, duke u promovuar në sajë të njohjes për shkak të arritjeve dhe karrierës në fusha të tjera të natyrës ligjore, pa qenë e nevojshme të kenë eksperiencë të mëparshme të lidhur me gjyqësorin. Përgjithësisht ata nuk promovohen dhe transferimi i tyre në nivele paralele pothuajse nuk ndodh asnjëherë. Për sa i përket mekanizmave të cilët bëjnë të mundur emërimin e gjyqtarëve referuar modelit të njohjes, ato përfshijnë degët e tjera të qeverisjes përfshi edhe zgjedhjen e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë (siç është rasti i disa shteteve të SHBA-ve).

9. Duke e parë në një vështrim krahasues çështjen e rezervimit të disa vendeve në Gjykatën e Lartë për juristët pa karrierë në gjyqësor, ky sistem zbatohet në shumicën e vendeve të civil law. Për shembull, në Spanjë, ky proces, ku si gjyqtarë përzgjidhen juristë dhe profesorë të së drejtës, njihet si “*cuarto turno*” për faktin se tri raundet e para të emërimit synojnë promovimin e gjyqtarëve të karrierës. Në Brazil,

¹⁰ Nuno Garoupa dhe Tom Ginsburg, *Hybrid Judicial Career Structures: Reputation Versus Legal Tradition*, botuar në Oxford Journals, 2011

¹¹ Nuno Garoupa dhe Tom Ginsburg, *The Comparative Law and Economics of Judicial Councils*, Berkeley Journal of International Law Volume 27 Issue 1 Article 3 2009.

Presidenti, pas propozimit nga shoqëria civile dhe organet e prokurorisë, mund të emërojë 1/5 e gjyqtarëve federal të apelit nga radhët e juristëve dhe prokurorëve, kategori që njihet si “*quinto constitucional*” për faktin se ata përbëjnë 1/5 e gjyqtarëve të gjykatave të larta, kurse pjesa tjetër përzgjidhet nga radhët e gjyqtarëve të karrierës. Një shembull tjetër është Japonia, ku ndërsa në gjykatat e nivele të ulëta zgjidhen gjyqtarë karriere, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë përfshijnë një kombinim midis gjyqtarëve të karrierës nga gjykatat e ulëta, profesorë të së drejtës, prokurorë, funksionarë publik dhe juristë. Në Francë, emërimi për nivele të larta në Conseil d’État është i hapur për funksionarë publikë me prestigj dhe juristë, proces i njohur si “*tour extérieur*”, pasi ata përbëjnë 1/3 e këshilltarëve të emëruar çdo vit. Në Holandë, hyrja në pushtetin gjyqësor është e hapur për juristët, profesorët e së drejtës dhe nëpunësit publikë që zotërojnë një diplomë në drejtësi, madje aktualisht kjo kategori përbën 70 për qind ose më shumë të të gjithë gjyqtarëve.

10. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, nga përmbajtja e nenit 3 të ndryshuar, rezulton se ligjvënësi ka parashikuar dy mënyra të promovimit të gjyqtarëve në sistemin gjyqësor. Kështu, krahas një kategorie e cila është pjesë përbërëse efektive e gjyqësorit dhe që të promovohet duhet domosdoshmërisht të plotësojë kushtet e kriteret ligjore, por edhe të gëzojë një reputacion kolektiv, pra mbështetje në komunitetin e gjyqtarëve, ekziston edhe një kategori tjetër juristësh, jashtë sistemit gjyqësor, që spikasin për vlerat e veçanta individuale, me reputacion individual dhe kontribut në fushën ligjore, të kufizuar në numër, pasi sipas ligjit në asnjë rast nuk mund të kalojë më shumë se 1/4 e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

11. Duke e vlerësuar parashikimin e mësipërm nën dritën e trajtesës së mësipërme, është e kuptueshme se ligjvënësi shqiptar, ka përcaktuar modelin e kombinuar “karrierë (3/4 e gjyqtarëve) – njohje (1/4 e gjyqtarëve)” si mekanizmin për emërimin e gjyqtarëve të lartë. Që një gjyqtar të synojë promovimin në sistemin gjyqësor, qoftë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë do të thotë që ai/ajo të plotësojë tërësinë e kushteve për t’u emëruar gjyqtar, procedurën dhe kriteret e emërimit të gjyqtarit në shkallët përkatëse si dhe mënyrën e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarit. Këto elemente, siç pranon edhe shumica, në tërësinë e tyre përbëjnë “*sistemin e karrierës*”.

12. Zhvillimi i karrierës sanksionohet edhe në Kartën Evropiane për statusin e gjyqtarit, dokument i cili, me qëllim bërjen më efektive të promovimit të pavarësisë gjyqësore, e nevojshme kjo për fuqizimin e epërsisë së të drejtës dhe për mbrojtjen e lirisë individuale brenda shteteve demokratike, në pikën 4.1 midis garancive të tjera, parashikon se: “*Kur nuk bazohet në vjetërsi, një*

sistem ngritjeje në pozitë bazohet përjashtimisht mbi cilësitë dhe meritat e vëna re në kryerjen e detyrave të besuara një gjyqtari/eje, me anë të vlerësimeve objektive të kryera nga një ose disa gjyqtarë dhe të diskutuara me gjyqtarin/en në fjalë. Gjyqtarët që nuk propozohen lidhur me ngritjen në pozitë duhet të kenë të drejtën të bëjnë një ankesë tek autoriteti përkatës.”. Karta nuk përcakton në mënyrë përfundimtare modelin e promovimit të gjyqtarëve, duke e lënë një zgjedhje të tillë në diskrecionin e ligjvënësit kombëtar, megjithatë nxjerr në pah parimet bazë mbi të cilat mundësohet zhvillimi i karrierës, konkretisht “*mbi cilësitë dhe meritat e vëna re në kryerjen e detyrave të besuara një gjyqtari/eje, me anë të vlerësimeve objektive*”.

13. Efektiviteti i punës së gjyqtarit përftohet edhe nga vlerësimi i përmbushjes së standardeve orientuese në aspektin sasior, cilësor dhe kohor të veprimtarisë gjyqësore, standarde të cilat janë të rivlerësueshme. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve duhet të jetë kryesisht cilësor dhe i përqendruar në aftësitë e tyre, ku përfshihen aftësitë profesionale (njohja e ligjit, aftësia për të drejtuar gjyqet, aftësia për të shkruar vendime të arsyetuara), aftësitë personale (aftësia për të përballuar ngarkesën e punës, aftësia për të marrë vendime, përshtatja me teknologjitë e reja), aftësitë shoqërore (aftësia për të ndërmjetësuar, respekti për palët) dhe për një avancim të mundshëm në një pozicion administrativ, aftësia për të drejtuar. Po këto aftësi duhet të kultivohen në programet e trajnimeve gjyqësore dhe në punë.¹²

14. Shumica arrin në përfundimin se: “*...karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht ndërmjet tyre. Mbi këto standarde kushtetuese duhet të orientohet veprimtaria ligjvënëse me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtave dhe përfitimeve që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë*” (prg.22)”.

15. Shumica krahas parashtrimit përmbledhtazi të risive të sjella nga ligjvënësi në ligjin organik për karrierën në pushtetin gjyqësor, i referohet edhe Kartës Evropiane për Statusin e Gjyqtarit. Ndërsa nga njëra anë ky fakt duhet vlerësuar se i shton vlerat vendimmarrjes, duke bërë pjesë të jurisprudencës kushtetuese praktikat më të mira në lidhje me garancitë e gjyqtarëve, nga ana tjetër, kuptimi që i është dhënë atyre dhe konteksti në të cilin është vendosur ky referim në çështjen konkrete është tërësisht i pavend.

¹² Shih “Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore”, përgatitur nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut, 23-25 qershor 2010 (<http://www.osce.org/sq/odihr/75490?download=true>)

16. Shumica pranon ekzistencën e një sistemi karriere në gjyqësor, kur arsyetohet se: *“Gjithashtu, për shkak se dispozita konkrete e lidh emërimin në Gjykatën e Lartë me shërbimin efektiv në gjykatën e apelit duhet që, në funksion të rritjes së cilësisë, sistemi aktual i progresit në karrierë, i parë në tërësi, të garantojë, vetëm mbi kritere objektive, promovimin e gjyqtarëve në gjykatat e apelit dhe më tej emërimin e tyre në Gjykatën e Lartë.”* Madje shumica pranon se: *“Nëpërmjet vendosjes së kushtit të punës 5 vjeçare si gjyqtar apeli për t’u emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë, ligjvënësi ka synuar pajisjen e gjyqtarit me një eksperiencë unike që, sipas tij, arrihet vetëm duke shërbyer efektivisht në gjykatën e apelit.”* Pavarësisht këtyre argumenteve, shumica, në mungesë të qartë të një rrjedhe logjike, arrin në përfundimin se: *“Në kushtet kur nuk ka argumente të qarta dhe bindëse në këtë drejtim nuk mund të thuhet se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis kriterit kufizues të vendosur nga ligjvënësi dhe objektivit që ai kërkon të arrijë.”* Kushdo që lexon një paragraf të tillë mund të shtrojë pyetjen se cili subjekt kishte detyrimin për të sjellë argumente të qarta dhe bindëse, përse eksperiencë 5 vjeçare në Gjykatën e Apelit përbën kriter kufizues, sepse të drejtën për të konkurruar për t’u promovuar gjyqtar në apel potencialisht e gëzon çdo gjyqtar i shkallës së parë. Shumica jo vetëm nuk jep asnjë argument në lidhje me këto pyetje, duke mos pasur guximin të pranojë se kriteri që ajo e cilëson si kufizues në të vërtetë përbën një nga garancitë e reja ligjore që siguron karrierën bazuar mbi vjetërsi dhe meritokraci.

17. Shumica e ka ngritur nocionin *“karrierë”* në nivelin e përfitimeve që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës duke u mjaftuar me argumente vetëm të natyrës përshkruese dhe aspak analizuese, pa sjellë asnjë argument mbi kriteret ku bazohet për cilësimin e këtij elementi si përfitim kushtetues dhe që si i tillë nuk mund të ulet. Edhe trajtimi i karrierës në kuadrin e të drejtave të fituara dhe, për rrjedhojë, vlerësimi nga këndvështrimi i parimit të sigurisë juridike është tërësisht i pavend, për faktin se promovimi në sistemin gjyqësor përbën një proces të dyanshëm, që përfshin si gjyqtarin, sistemin e drejtësisë në tërësi ashtu dhe interesin publik. Pritshmëria e ligjshme e çdo gjyqtari për të bërë karrierë në sistemin gjyqësor, para së gjithash, do të thotë krijimi i mundësive dhe shanseve të njëjta në dispozicion sipas kriterëve e kushteve ligjore. Shumica këtë

fakt nuk e merr aspak në konsideratë, madje vendimi karakterizohet jo vetëm nga mungesa e analizës kushtetuese, por edhe përpjekjet e shumicës për të analizuar modelin mbizotërues të promovimit në sistemin gjyqësor janë sa kontradiktore aq dhe konfunduese.

18. Gjithashtu edhe arsyetimi i shumicës për mungesën e ndërhyrjes proporcionale të ligjvënësit nuk përbën aspak një argument të bazuar e bindës, për faktin se mungon analiza e nevojshmërisë, përshtatshmërisë dhe arsyeshmërisë së ndërhyrjes legjislative. Përkundrazi, argumentet e shumicës dukshëm nxjerrin në pah probleme që kanë të bëjnë me zbatimin në praktikë të ligjit, konkretisht me mosrespektimin e kriterëve objektive të promovimit në gjykatën e apelit, të tilla që kanë të bëjnë me cilësitë dhe meritat në ushtrimin e detyrës, kualifikimet, integritetin, aftësinë dhe efikasitetin, të identifikueshme përmes vlerësimeve objektive. Bazuar edhe në pretendimet e kërkuarit janë pikërisht këto mangësi të funksionimit të sistemit të karrierës të cilat bëjnë thuajse të pamundur promovimin në Gjykatën e Lartë.

19. Pavarësisht natyrës së pretendimeve, shumica zgjedh rrugën më të lehtë, atë të ushtrimit të tagrave të ligjvënësit pozitiv dhe të ndryshimit të sistemit të promovimit në sistemin gjyqësor. Në këtë rast shfuqizimi nga shumica i kriterit prej *“5 vjetësh si gjyqtar apeli”* bie ndesh me *ratio legis*, pasi e transformon logjikën e sistemit të karrierës nga një sistem me ngritje në varësi të eksperiencës dhe kontributit në secilën shkallë të pushtetit gjyqësor në një sistem promovimi i cili nuk siguron karrierë.

20. Sistemet e kombinuara të promovimit në sistemin gjyqësor bëjnë të mundur realizimin e objektivave më të gjerë sociale dhe profesionale dhe, po ashtu, lejojnë bashkëekzistencën e niveleve të ndryshme të ekspertizës në gjyqësor, çka i përgjigjet më mirë nevojave të veçanta për forcimin e pushtetit gjyqësor dhe eliminimin e fenomeneve negative. Për rrjedhojë, duke ndryshuar natyrën e promovimit në sistemin gjyqësor nga ai i bazuar në kombinimin e karrierës dhe njohjes në një sistem të paqartë, shumica cenon kërkesën për një sistem më të përgjegjshëm gjyqësor dhe, për rrjedhojë, nuk kontribuon në forcimin e shtetit të së drejtës, ku pavarësia dhe paanshmëria e pushtetit gjyqësor përbën një nga shtyllat bazë.

Anëtare: Vitore Tusha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 44 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006